

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”

Universiteti i New York Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PHD Elvin Gjevori



PHD Gert Guri



(Nëntor/2018)

Faqe 1 nga 89

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York –ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Drjtësisë dhe Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 939, datë 03.09.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMASh Nr. 170, datë 20.04.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve	17 studentë

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në “Marredhenie Nderkombetare”

Universiteti i “New York-ut” në Tirane (UNYT) filloi aktivitetin e tij duke u licensuar si Universitet privat në perputhje me dispozitat ligjore në vitin 2002, ndërsa nisi të ofronte diploma për sistemin Bachelor në degët Administrim Biznesi (dhe Komunikim), Kontabilitet, Finance, Marketing, Menaxhim, Ekonomiks, Shkencë Kompjuterike (Sisteme Informatike), si edhe Gjuhë dhe Letërsi Angleze. Në vitin akademik 2003-2004, oferta u zgjerua me programe të reja sic janë Shkencë Politike, Marredhenie Nderkombetare, Komunikim dhe Gazetari, si edhe Psikologji. Programet Bachelor të siperpervendura janë zhvilluar në bashkëpunim me State University of New York/Empire State College në SHBA, në vazhden e eksperiences se të tjere universiteteve simotra të akredituara në Greqi, Çeki, etj. Në këte kuader, studentet e nivelit Bachelor, në mbarim të studimeve, përveç diplomes nga UNYT kanë mundësinë që të marrin një diplomë të dyfishtë me Empire State College në rast se plotësojnë detyrimet shtese prej 32 kreditesh të kerkuara nga ky institucion.

UNYT është njohur si “Universitet” në vitin 2012, ndërsa u akreditua për programet specifike nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Shqipërisë në Dhjetor të vitit 2006. Ri-akreditimi institucional u konfirmua në vitin 2015. Në vitin 2017 iu nënshtrua akreditimit periodik institucional me agjencin Britanike QAA dhe ASCAL. Programi MA në Marredhenie Nderkombetare terheq një larmi studentesh jo vetëm nga rajoni por edhe nga vende të tjera cka garanton një larmi gjuhësore dhe kulturore të pjesëmarrësve të këtij programi. Të gjithë programet funksionojnë në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Neë-York dhe Kolegjin Shtetëror të Empire.

UNYT është ndërtuar mbi tre fakultete: Fakulteti i Informatikës i cili përbëhet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra e Kerkimit të Avancuar Kompjuterik; Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit i cili përbëhet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Finances, Departamenti i Administrim Biznesit dhe Qendra Kerkimore për Ekonomine dhe Biznesin; Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, ku dhe ofrohet programi i marre në shqyrtim përbëhet nga Departamenti i Drejtësisë dhe Humanistikës, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Qendra Kerkimore për Shkencat Sociale.





Fig: 1. Struktura e UNYT

UNYT është organizuar në baze të një ndarje të qarte (por edhe bashkëpunimi) institucionale ndërmjet organeve të sipërmarrjes, akademike dhe atyre administrative. Institucioni më i lartë i vendim-marrjes dhe hartimit të politikave është Bordi i Aksionereve. Presidenti i Universitetit përfaqëson Bordin e Drejtoreve, i cili bashkëpunon me Bordin Akademik të institucionit, organi më i lartë i vendim-marrjes në politikën akademike (programet e studimit, organizimi i kurrikulave etj). Bordi Akademik udhëhiqet nga Rektori i Universitetit dhe ka në përberje të tij edhe zv. Rektorin dhe një anëtar i cili përfaqëson institucionet partnere të Universitetit. Vendimet që kanë të bëjnë me problemet akademike shqyrtohen nga Këshilli Akademik i përbërë nga kryetarët e departamenteve, ndërsa vendim-marrja për programet e diplomimit është nën varesinë e Këshillit të Diplomimit, i cili përbehet nga Drejtoret e Programeve të Diplomimit. Aspektet që i takojnë programeve universitare dhe atyre pasuniversitare janë në kompetencën e asamblese së akademise, e cila në pjesën më të madhe përbehet nga pedagogët me kohe të plote. Brenda departamenteve veprojnë instanca të ngarkuar me zbatimin e funksioneve administrative dhe menaxheriale të mbarevajtjes së universitetit, nën kompetencën e Presidentit të Universitetit.

Bordi Akademik ka një rol përcaktues jo vetëm në aprovimin e strategjive të zhvillimit të universitetit (për propozimeve nga ana e Këshillit Akademik) por edhe në aprovimin e propozimeve për të tjerë sipas interesave strategjike. Këshilli Akademik është një organ kolegjal i vendim-marrjes, i cili përcakton: zhvillimin e politikave të institucionit; i planifikon ato; i koordinon; i drejton; kontrollon aktivitetin mësimor dhe akademik; vlerëson efikasitetin; vendos mbi problematikat që mbart institucioni në lidhje me aktivitetet e mësimdhënies ose të kërkimit shkencor.

Programi i studimit Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale, i cili ofron programe të nivelit Bachelor, Master dhe PhD. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare është një njësi bazë e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale.



GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ: Bordi i Akteditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: PhD Elvin Gjevari dhe PhD Gert Guri ekspertë të jashtëm vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku.

Më datë 21.11.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertet e vlerësimit. Në datë 26.11.2018 Institucioni ktheu përgjigje në formë zyrtare në lidhje me Draft – RVJ, në të cilën sprehet se **nuk ka komentet** në lidhje me të.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Te kete nje numer me te madh te personelit akademik me orar te plote ne program (krahasuar me orarin me kohe te pjesshme);
- b) Te ndertohet nje kampus per studentet;

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për te permbushur kete rekomandim, institucioni ka rritur numrin e personelit me kohe te plote, i cili kontribuon ne kete program me 6 anetare te rinj: nje prej te cileve mban graden e profesorit kurse 5 te tjeret mbajne graden doktor i shkencave. Kjo rritje ne numer eshte bere duke siguruar vazhdimesine e angazhimit nga pedagoget me me eksperience te ketij programi te cilet vazhdojne te kontribuojne qe nga fillimi i ketij programi. Kjo nderthurje e prurjeve te reja me pedagoget më me eksperience mendojme se ndihmon ne mbarevatjen me te mire te ketij programi.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- b) Për rekomandimin mbi ndertimin e nje kampusi te ri mendojme se rekomandimi eshte plotesuar sepse nga akreditimi i fundit UNYT ka kaluar ne nje ndertese te re duke ruajtur ndertesën e meparshme per funksione kryesisht te stafit administrativ. Ne kete menyre eshte siguruar nje hapësire me e madhe si per te zhvilluar procesin e mesimdhënies me studentet ashtu edhe per te siguruar hapësirat e nevojshme per zhvillimin e punes shkencore nga stafi akademik. Per me tej, UNYT po nderton edhe nje kampus te ri i cili do te integroje te gjitha aktivitetet si te mesimdhënies ashtu edhe kerkimore te universitetit, gjate vizites mesuam se ky kampus i ri shpresohet qe te jete gati per vitin e ri akademik.

GVJ vlerëson se rekomandimi është përmbushur plotësisht.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Ky program mesimor ofron një sërë objektivash, por qelimi kryesor është rritja e nivelit të mesimdhënis cka do të mundesoje edhe arritjen e rezultateve të planifikuara në periudhë disjavë (2018-2022). Për të arritur këto qëllime janë vendosur një sërë objektivash siç janë rritja e nivelit shkencor të pedagogëve si nepermjet avancimit në karrirën e akademike (ka ngritje në një shkallë akademike të përhumbësive të gjithë pedagogëve të programit në periudhën nga akreditimi i fundit) ashtu edhe në pjesëmarrjen në konferenca apo projekte shkencore ndërkombëtare (Aneks 1, dhe 2.2).

Koordinimi i punës bëhet në përputhje me përgjegjësitë e çdo pozicioni (si institucionale ashtu edhe akademike e kërkimore). Për të mundësuar kërkimin shkencor, ndarja e ngarkesës në programin mesimor kryhet në përputhje edhe me pozicionet akademike apo institucionale të secilit pedagog. Kështu anëtarët e Qendrës të Kërkimit kanë një ngarkesë mesimore me të vogël se pedagogët e tjerë, për të mundësuar përkrahjen e kërkimit shkencor. Në të njëjtën logjikë, edhe Dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve kanë një ngarkesë me të kufizuar mesimore në përputhje me aktivitetet e tyre institucionale. Procesi i mesimdhënis koordinohet nga Departamenti ku bën pjesë programi akademik përkatës duke bashkëpunuar kur është e nevojshme edhe me departamente të tjera (Shtojca 1 dhe 2).

Një kujdes i veçantë është treguar në shpjegimin nepermjet deliverables konkrete se çfarë synohet në çdo fazë të caktuar dhe me çdo objektiv. Ky hap është bërë duke ndarë objektivat strategjike në qëllime për të arritur dhe veprimtarinë konkrete dhe për arritjen e këtyre qëllimeve janë hartuar nën-objektiva me afate të ndryshme kohore.


Objektivat e Masterit janë parashtruar në përputhje me objektivat e institucionit i cili në të njëjtën periudhë kohore e fokuson aktivitetin e tij në të njëjtat objektiva siç janë ndërkombëtarizimi i studenteve pjesëmarrës dhe rritja e nivelit të mesimdhënis nga ana e pedagogëve. Programi i përgjithshëm akademik integrohet edhe me aspekte me të specializuara të interesave përkatëse të studenteve nepermjet temave të tezave të masterave apo edhe kryerjes së praktikave mesimore. Për këto qëllime UNYT mbikqyr në mënyrë të institucionalizuar në të gjitha nivelet tezat e masterave apo mikro-tezat (në nivel BA) jo vetëm aspektin shkencor por edhe atë etik.

IAL ofron edhe një infrastrukturë të përshtatshme për këto qëllime duke filluar nga biblioteka deri tek abonimet në revistat e specializuara për këtë program (Shtojca 1).

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion:
- Nevojat e tregut të punës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Si në shpjegimet e dhëna në RVB ashtu edhe në dokumentat e paraqitura ka një ndërlidhje ndërmjet misionit dhe objektivave të strategjive afatshkurtra dhe afatmesme të programit. Kështu edhe në këto master ashtu si edhe në misionin i IAL punësimi i studenteve është pjesë e misionit, ndërkohe që për vetë profilin e programit institucionet publike por edhe ato ndërkombëtare mbeten një alternative
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	

<p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p>	<p>kryesore. Sic u tha edhe me lart ka nje perputhje te kenaqshme te programit te studimeve me misionin dhe qellimin e institucionit duke marre parasysh karakteristikat e programit.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Zhvillimi i programit ne bashkepunim me nje universitet nderkombetar ne SHBA eshte padyshim nje argument i sakte ne shpjegimin e potencialit te punesimit qe ofron programi (duke mundesuar punesimin edhe jashte vendit). Studimi i kryer nga UNYT "Market Research Strategy" shpjegon jo vetem menytrat qe ndiqen per te kuptuar nese programet akademike kane nje perputhje me kerkesat e tregut te punes, por edhe avantazhin qe programi ne fjale ka me te tjere IAL qe ofrojne kete tematike masteri.</p> <p>Ne informacionin e ofruar si ne RVB ashtu edhe ne analizen e nevojave tregut te punes ofrohet nje pasqyre e fushave kryesore te zhvillimit te nevojave qe ka vendi per eksperte te ketij profili. Pervec perpjekjeve per nje perputhje sa me te plote eshte pozitiv fakti qe ekziston nje mekanizem i cili monitoron vazhdimisht dinamikat e ndryshimeve dhe i pasqyron ato ne silabuset dhe temat e programit.</p> <p>Informacioni i paraqitur shpjegon ne menyre te qarte se si vlerat kulturore dhe politike te vendit si nje shtet demokratik promovohen dhe ruhen nepermjet jo vetem leksioneve frontale por edhe detyrave te kursit me tematika nga sfidat dhe objektivat e integritit te shtetit dhe shoqerise shqiptare.</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programet e studimeve jane pershtaur me strategjine e zhvillimit te institucionit si persa i takon objektivate te zhvillimit (rritja e nivelit te mesimdhënies apo edhe nderkombetarizimi i metejsheem i studenteve) por edhe ne periodizimin e proceseve ne etapa te percaktuara qe synojne permbushjen ne hap ate planifikuar te misionit te institucionit, sic shpjegohet ne dokumentin mbi objektivat dhe misionin e programit ne fjale.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Permbajtja e programave eshte hartuar duke permbushur normal ligjore dhe nenligjore ne fuqi si edhe dispozitat dhe rregulloret e enteve pergjegjes sic jane Ministria e Arsimit Rinise dhe Sporteve apo ASCAL. Akreditimi i meparshem ka dhene nje ndihmesë në këtë drejtim, por vihet re edhe një kujdes i vazhdueshëm në përmbushjen e kriterëve ligjore.</p> <p>Emertimi i programit te studimit te ofrurar dhe njohurite ne dispozicion te studenteve qe marrin pjese ne program jane ne perputhje me nivelin 7 te Kornizes Shqiptare te Kualifikimit dhe me karten e Bolonjes.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mesimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mesimdhënies dhe të të nxënit.</p> 	<p>Institucioni ka hartuar dy plane strategjike: i pari per periudhen 2013-2017 dhe i dyti per periudhen 2018-2022. Ne keto plane shprehen qarte jo vetem objektivat por edhe mekanizmat e kontrollit te brendshem qe ka ndertuar institucioni per te vleresuar progresin e arritur ne perrmiresimin e programeve te studimeve - vecanerisht ne seksionin e planit strategjik kushtuar zhvillimit dhe perrmiresimit te Programeve të Studimeve.</p> <p>Në planin strategjik, IAL paraqet procedurat dhe planet për përmirësimin e rezultateve të mesimdhënies dhe të të nxënit. Harmonizimi i planit strategjik te programit me strategjine e</p>



universitetit ka bere te mundur qe te trajtohen ne nivelet e duhura sfidat qe kane te bejne me permiresimin e mesimdhenies. Disa prej tyre mund te adresohen vetem ne nivel IAL ndersa disa te tjerat jane specifike per programin.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ofron programe të cilat janë në përputhje me misionin e tij dhe strategjitë afatshkrutra dhe afatmesme të zhvillimit, si edhe një procedurë periodike për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve mësimore.
2. Programi ka nje vizion te qarte strategjik i cili perputhet jo vetem me misionin e institucionit pro edhe me dispozitat ligjore dhe nen-ligjore.
3. Programi merr ne shqyrtim por edhe institucioni ofrojne mekanizma funksionale per te kontrolluar progresin e rritur dhe per te ndermarre hapat korrektive te nevojshem.

Rekomendim:

Kryerja e nje studimi apo nje paraqitje me e sakte e kerkesave te tregut te punes nepermjet proxy-indikatoreve si p.sh. niveli i punesimit te studenteve te diplomuar prane ketij programi dhe cfare ndryshimesh duhet te ndiqen per te plotesuar me mire dhe me cilesishem nevojat vazhdimisht ne evolucion te tregut te punes.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Njesite e fakultetit jane te organizuara ne perputhje me dispozitat ligjore, ndersa vihet re nje kujdes per te zbatuar procedurat te cilat bejne vleresimin e nivelit te mesimdhenies dhe marrin masa korrektuese, si edhe nje nderveprim ndermjet strukturave akademike dhe atyre manaxheriale. Ne perputhje me aktet dhe dispozitat ligjore ne fuqi, cdo departament dhe Qender Kerkimore ka nje staf prej 7 anetaresh me kohe te plote, dhe secili prej ketyre anetareve mban te pakten graden akademike te Doktorit te Shkencave (ose PhD). Pervec pedagogeve me kohe te plote kane disa pedagoge me kontrata me kohe te pjesshme sidomos ne lendet juridike ku kerkohet nje specializm me i studiuar i stafit akademik. Stafi i prezantuar ka nje nivel ne perputhje me kriteret ligjore (si persa i takon numrit ashtu edhe gradave akademike) por ne krahasim me vitin akademik 2016-2017 numri i stafit me kohe te plote prane departamentit te Shkencave Humane dhe Sociale ku edhe eshte mbeshtetur programi eshte ulur nga 8 ne 7 ndonese persa i takon nivelit akademik te PAE kemi nje ndryshim pozitiv pasi ne vitin akademik 2017-2018 kemi 1 PAE me graden profesor (nga profesor i asociuar) dhe nje PAE me graden kandidat shkencash ne doktor shkencash. Po keshtu eshte ulur edhe numri i PAK nga 6 ne 3 cka eshte shoqeruar edhe me nje ulje te lehte te nivelit akademik (shih paragrafin perkates ne vijim).

GVJ konstaton se Dekania e Fakultetit mban gradë PhD dhe jo titullin "Profesor" sic kërkon neni 42 i Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë.

Departamenti është njësia bazë e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për secilin nga programet akademike dhe roli i tij është jo vetëm të stimulojë dhe bashkërendojë mësimdhënien në nivelet e

ndryshme të programeve që ofron, por edhe të bashkërendojë punën në drejtim të kërkimit akademik. Departamenti propozon drejtimet strategjike dhe ndryshimet përkatëse për sa i takon kurrikulave, përcakton programet si edhe evidenton nevojat për staf akademik pranë dekanit të fakultetit dhe rektorit të universitetit.

Drejtuuesi (Përgjegjësi) i Departamentit është autoriteti më i lartë i njësisë mësimore-kërkimore dhe është përgjegjës për veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në secilin nivel akademik të departamentit si edhe dhe për drejtimin sa me efikas të aktiviteteve brenda tij. Përgjegjësi i Departamentit përfaqson dhe vepron në emër të Departamentit dhe është pjesë e personelit akademik dhe është te paktën me gradën Doktor Shkencash. Një rol të veçantë në këtë proces vendim-marrje luan Këshilli i Akademik, i cili përbehet nga Shefat e departamenteve dhe komunikon me Rektorin, Zv.Rektorin dhe dekanet e të tre fakulteteve lidhur me hapat e mëtejshëm që duhen të ndërmerren në procesin akademik dhe atë të mesimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit


Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale pranë të cilit është mbështetur edhe programi i studimit Master i Shkencave në Marrëdhënie Ndërkombëtare konsiston në tre njësi bazë (2 departamente dhe një qendër kërkimore)

- Departamenti i Drejtësisë dhe Humanistikës;
- Departamenti i Shkencave Shoqërore; dhe
- Qendra Kërkimore për Shkencat Shoqërore.

Programi MSc në Marrëdhënie Ndërkombëtare është mbështetur pranë departamentit të Shkencave Sociale dhe ofron programet: 1. BSc në Marrëdhëniet Ndërkombëtare/Shkenca Politike; 2. BSc në Psikologji; 3. Dhe MSc në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Në vijim prezantohet në mënyrë skematike organigrama e Fakultetit si edhe ndarja në departamentet përkatëse.

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)



Sic shihet edhe nga informacioni i prezantuar ne RVB ka nje ndarje ndermjet strukturave akademike dhe atyre qe kane funksione me menaxheriale. Ky eshte nje organizim pozitiv pasi krijon mundesine qe stafi akademik te kete nje ze te pavarur duke krijuar nje ekuliber ne perfaqesimin e interesave akademike perpos atyre manaxheriale. Pervec pjesmarrjes ne Asamblene se Akademise, ku bejne pjese pedagoget me kohe te plote edhe te ketij fakulteti, interesat akademike perfaqesohen edhe nga Kryetaret (Pergjegjesit) e Departamenteve nepermjet pjesmarrjes se tyre ne Keshillin Akademik te Universitetit.

Fakulteti ofron programesh mesimore ne nivelet nga Bachelor dhe Master Shkencor ndersa per momentin nuk ofrohen programe doktorale. Krijimi i programeve doktorale do te krijonte mundesine e formimit te njohurive dhe kompetencave jo vetem nga ana e studenteve por edhe e stafit akademik. Fakulteti ka evoluar ne zhvillimin e tij per te permbushur me mire nevojat dhe sfidat e parashtuara.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Programi ofrohet nga njesia baze akademike qe eshte Departamenti i Shkencave Sociale, ndryshuar nga Departamentin e Shkencave Humane ne vitin akademik 2017-2018. Ne kete departament (shih Tabelen 1 ne aneks) ne vitin akademik 2017-2018 kane dhene mesim 10 pedagoge prej te cileve 7 jane PAE dhe 3 jane PAK. Ndermjet PAE te gjithe pedagoget jane me tituj dhe grada: 1 PAE profesor 6 doktore shkencash (PhD). Persa i takon PAK numri i atyre te cilat kane grada akademike eshte si vijon: 3 doktore shkencash (PhD). Persa i takon raportit PAE/PAK ne departamentin e Shkencave Sociale sipas gradave situata paraqitet si vijon: ne nivelin profesor PAE 1/ PAK 0; ne nivelin profesor i asociuar PAE 0/ PAK 0; ne nivelin doktore shkencash PAE 6/ PAK 3; ne nivelin pedagoge ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash PAE 0/ PAK 0. Ka nje numer me te madh te PAE ne krahasim me me PAK (gati dy here me shume) e cila respektohet edhe persa i takon nivelit me te larte ne gradat shkencore ndermjet PAE dhe PAK.

Ne Departamentin e Shkencave Humane dhe Sociale (ndryshuar ne Departamenti i Shkencave Sociale ne vitin akademik 2017-2018) ne vitin akademik 2016-2017 (shih Tabelen 1 ne aneks) kane dhene mesim 14 pedagoge prej te cileve 8 jane PAE dhe 6 jane PAK. Ndermjet PAE 6 jane me tituj dhe grada: 1 profesor i asociuar, 5 doktore shkencash (PhD), ndersa pjesa e mbetur (2 PAE) jane personel akademik ndihmes i perbere nga pedagoge ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash. Persa i takon PAK numri i atyre te cilat kane grada akademike eshte si vijon: 1 profesori asociuar, 4 doktore shkencash dhe 1 PAK ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash. Persa i takon raportit PAE/PAK ne departamentin e Shkencave Humane dhe Sociale sipas gradave situata paraqitet si vijon: ne nivelin profesor PAE 0/ PAK 0; ne nivelin profesor i asociuar PAE 1/ PAK 1; ne nivelin doktore shkencash PAE 5/ PAK 4; ne nivelin pedagoge ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash PAE 2/ PAK 1. Ka nje balance ndermjet PAE/PAK e cila respektohet jo vetem per graden e profesorit te asociuar por edhe persa i takon niveleve te tjera.

Ne vitin akademik 2017-2018 perberja e pedagoqeve te departamentit ne lidhje me gradat dhe numrin e paraqitet e ndryshme krahasuar me vitin akademik 2016-2017. Ne vitin 2017-2018, numri i pergjithshem i pedagoqeve eshte ulur nga 14 ne 10, vecanerisht i atyre PAK nga 6 ne 3, ndersa numri i PAE eshte ulur nga 8 ne 7. Persa i takon nivelit akademik te PAE kemi nje ndryshim pozitiv pasi ne vitin akademik 2017-

2018 kemi 1 PAE me graden profesor (nga profesor i asociuar) dhe nje PAE me graden doktor shkencash (PhD) nga kandidat shkencash. Ndersa persa i takon PAK verejme edhe me nje ulje te lehte te nivelit akademik te tyre (1 professor i asociuar me pak).

Duke konsideruar qe fakulteti ka nje staf administrativ prej 21 mendojme se departamenti ne fjale ka nje staf administrativ te perbere pre 7 personash duke e ofruar keshtu nje raport 14:7 (ose gati 2:1) ndermjet stafit akademik dhe atij administrativ. Stafi administrativ mbulon pozicionet qe i takojne zyres se sekretarise (regjistrimit) dhe asaj te kordinimit te departamentit.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje 3 fakultete (dhe departamentet e qendrat kerkimore përkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një masteri, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit përkatës por edhe nga fakultetet e tjera. Per t'iu pergjigjur me mire kerkesave eshte bere edhe ri-organizimi. Organizimi i institucionit harmonizon strukturat i UNYT me nje Fakultet me te dedikaur per shkencat juridike dhe sociale dhe nje departament (Departamenti i Shkencave Humane dhe Sociale) te fokusuar me shume ne procesin e mesimndhenies dhe cilesise se programit. Ka nje nderthurje ndermjet strukturave akademike me ato vendim-marrese dhe administrative. Strukturat akademike jane te nderlidhura dhe propozojne prane strukturave manaxheriale ndryshimet e nevojshme.</p> <p>UNYT eshte i organizuar ne tre fakultete: Fakulteti i Ekonomise dhe Biznesit; Fakulteti i Informatikes; Fakulteti i Drejtesise dhe Shkencave Sociale duke përmbushur kështu dispozitat ligjore.</p> <p>Fakultetet jane te organizuara ne se paku tre njesi baze, te cilat konsistojne ne departamente ose qendra kerkimore. Fakulteti i cili organizon programin e marre ne shqyrtim eshte organizuar ne tre njesi baze: dy departamente: Departmenti i Drejtesise dhe Humanistikës; Departmenti i Shkencave Shoqerore si edhe Qendra Kerkimore per Shkencat Shoqerore. Te trija keto njesi funksionojne ne baze te objektive dhe misioni te mire-percaktuar dhe nderthurur me strategjine e zhvillimit te universitetit 2018-2022.</p> <p>Departamenti ka ne perberjen e tij 7 anetare efektive nga cilet 1 PAE mban graden profesor dhe 6 PAE mbajne graden doktor shkencash duke plotesuar keshtu kriterin e parashikuar nga dispozitat ligjore.</p>
4Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në informacionin e paraqitur në rregulloren e programit të masterit, apo ne dokumentin "Evaluation Manual" dhe "Students' Evaluation Forms" përshkruhen procedurat dhe mekanizmat që janë vendosur për të siguruar realizimin e programeve të studimit dhe kontrollin e cilësisë. Procedurat të cilat sigurojnë realizimin e programeve janë p.sh. ballafaqime periodike me studentët dhe organizimi i pyetësorve me</p>

studentët, frekuenca me të cilën ripërtërihen programet mësimore, etj. Njesite baze kane objektiva te qarta persa i takon realizimit te programeve te studimeve, te cilat harmonizohen ne nivel fakulteti dhe universiteti. Zbatimi i procedurave per kontrollin dhe permiresimin e vazhdueshem te cilesise se mesimdhënies jep nje ndihmese te qarte ne kete drejtim.

Procesi i paraqitur, ne rregulloren e programit, qe nga evidentimi i nevojës per pedagoge (nga departamenti) dhe aprovimi (nga ana e rektoratit), frekuenca e paraqitjes se nevojave dhe marrja ne pune e personelit ne kohe te percaktuar per te siguruar plotesimin e kerkesave te bera nga departamenti, deshmon per nje pjesmarrje te personelit akademik ne te gjitha hapat e rekrutimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Numri i pedagogëve efektive si edhe niveli i tyre akademik eshte me i larte se kriteret e paraqitura nga dispozitat ligjore
2. Ka nje organizim te kenaqshem te struktures se fakultetit duke harmonizuar njesite baze me procesin e vendim-marrjes por edhe me bashkerendimin e punes ndermjet tyre (sic eshte rasti i keshillit akademik apo asamblese se akademise inter-disiplinare) si edhe bashkepunimi ndermjet niveleve te ndryshme akademike.
3. Organizimi i strukturave te fakultetit dhe departamentit permbushin kerkesat ligjore.
4. **GVJ konstaton se Dekania e Fakultetit mban gradë PhD dhe jo titullin "Profesor" sic kërkon neni 42 i Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik i programit, për vitin akademik 2017-2018, përbëhet nga 6 pedagogë. Kualifikimi i personelit akademik eshte ne nje nivel te kenaqshem si persa i takon numri te pedagogëve ne raport me studentet ashtu edhe kualifikimit te tyre (te gjithë kane te pakten graden doktor dhe jane diplomuar jashte vendit). Ne vitin akademik 2017-2018, raporti i studenteve me personelin akademik PAE eshte mesatarisht 1/1 (pasi ne cdo vit numri i studenteve te regjistruar ne program eshte 1-8 studente) me perjashtim te vitit akademik 2012-2013 (pasi ne kete vit akademik ishin regjistruar 13 studente). Ka një numër të lartë pedagogësh për numrin e studentëve të regjistruar në këtë program dhe për ngarkesën që këta pedagogë dedikojnë në programin e paraqitur për akreditim. Kjo shpërndarje harmonike e ngarkesës vihet re si përse i takon mësimdhënies ashtu edhe praktikave mësimore dhe ndjekjes së punës për përfundimin e tezës së masterit. Nderkohe edhe raporti i studenteve me PA (7 PA ndjekin kete program) eshte mesatarisht 1/1. Ne pothuajse te gjithë periudhen e akreditimit te programit aktiviteti akademik eshte mbuluar teresisht nga PAE (ben perjashtim vetem vitit akademik 2012-2013 ku raporti PAE/PAK ka qene 3/2). Ndersa per vitin akademik 2017-2018 ky raport eshte PAE/PAK 6/0. Ne kete vit akademik kemi nje shperndarje te titujve ne program si vijon: 1 profesor dhe 5 doktore shkencash (nje informacion me i plote ofrohet ne seksionin perkates).

Lidhur me kualifikimin e stafit, stafi PAE ne vitin akademik 2017-2018 paraqitet si vijon: 1 PAE në program mban titullin Profesor dhe 5 PAE mbajnë gradën doktor shkencash (PhD). Përse i takon raportit midis femrave dhe meshkujve vihet re një lloj njëanshmërie ne nivelin e gradave akademike



pasi ne nivelin e Profesorit dhe Profesorit të Asociuar nuk ka asnjë femër ndërsa në nivelin e Doktorit te Shkencave ky raport është 4/1 në favor të PAE meshkuj.

Një tjetër aspekt që meriton vëmendje, i cili është sqaruar më në detaje në seksionin përkatës, është edhe ai i shpërndarjes se njetrajtshme moshore, me te gjitha segmentet moshore te mbuluara nga PAE. Ndonese ka nje tendence normale te shperndarjes moshore me 3 PAE per graden doktor shkencash (PhD kryesisht në moshën 36-45 dhe per graden profesor ne sgmentin moshor 56-65 vjec.

Procesi i rekrutimit behen duke ndjekur procedura publike dhe nga kritere te percaktuara qarte ne rregulloret e institucionit dhe mbi nje baze transparente te paraqitjes se kritereve duke respektuar keshtu dispozitat ligjore (shih aneksin Procedure of Faculty Hiring dhe IR Vacancy). Ne dokumentacionin e paraqitur janë peraktuar dy tipologji të veçanta kontratash për personelin PAE dhe PAK. Kjo edhe duke patur parasysh profilet, kërkesat dhe angazhimin e ndryshëm të këtyre dy figurave pranë Institucionit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 2 në Aneks)

Në Tabelat 2 (shiko Aneks) prezantohet numri dhe gradat e pedagogëve të angazhuar në programin Master Shkencor në Marrëdhënie Ndërkombëtare për vitin akademik 2017-2018 dhe për vitet e tjera që prej akreditimit të parë të këtij programi studimi. Per vitin akademik 2017-2018 ka nje nivel te kenaqshme te PAE si ne drejtim te numri 6 pedagoge ashtu edhe parsia i takon nivelit te tyre akademik: grada me e ulet eshte ajo e doktorit, nderkohe qe ka nje profesor. Numri i PAE ne vitin e fundit akademik eshte rritur nga 5 ne 6 cka mendojme se ndikon poitivisht ne cilesine e mesimdhenies. Megjithate, bie ne sy fakti se nuk ka asnje PAK ne program, ndoshta edhe per vete numrin e larte PAE (aktualisht raporti personel akademik student ne program eshte 6 pedagoge per 7 studente).

Duke qene se institucioni ndjek nje politike per mesimdhenie ne kete program vetem nga PAE (me perjashtim te vitit akademik 2013-2014) per pothuajse te gjitha vitet akademike qe nga akreditimi i fundit i programit, do te paraqesim ne vijim pasqyren e perberjes dhe gradave te PAE qe marrin pjese ne kete program per te gjitha keto vite akademike:

1. Për vitin akademik 2017-2018 gradat e 6 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, dhe 5 PhD/Dr.
2. Për vitin akademik 2016-2017. gradat 5 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, dhe 4 PhD/Dr
3. Për vitin akademik 2015-2016 gradat 7 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, 1 Prof. As, dhe 5 PhD/Dr.
4. Për vitin akademik 2014-2015 gradat 6 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, 1 Prof. As, 3 PhD/Dr, dhe 1 PAE ne procesin e marrjes se grades doktor shkencash.
5. Për vitin akademik 2013-2014 raporti eshte PAE 3/PAK 2. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor dhe 2 PhD/Dr. Ndërsa PAK eshte 1 Profesor dhe 2 PhD/Dr. Për vitin akademik 2012-2013 programi nuk ka funksionuar per shkak te numrit te ulet te studenteve te regjistruar.



- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 3 në Aneks)

Në Tabelën 3 (shiko Aneks) janë paraqitur anëtarët e Këshillit Shkencor të programit. Këshilli shkencor ka 3 anetare njeri prej të cilëve luan edhe rolin e korrodinatorit. Pjesëmarrja është e kënaqshme si përsa i takon cilësisë së pedagogëve. Kështu në Këshill bëjnë pjesë 1 Profesor dhe 2 doktorë shkencash. Anëtarët e Këshillit kanë të gjithë profilin akademik (fushat e specializimit dhe kërkimit) si edhe përvojën e nevojshme në mesimdhënie në këtë program (ndonese ka edhe pedagogë të rinj në eksperiencë). Të gjithë anëtarët e këshillit shkencor janë edhe anëtarët e programit. Megjithatë do të ishte më frytdhënëse edhe pjesëmarrja e figurave akademike jashtë programit të cilët mund të ofrojnë një mendim ndryshe dhe të nxisin kritikën konstruktive. Për më tej mungesa e PAK në program bënte të nevojshëm që në Këshillin Shkencor të kete një mendim akademik me personalitete të kësaj fushe, të cilat nuk bëjnë pjesë në program, ndryshe mund të zhvillohet në të ardhmen një menaxhim tautologjik i programit akademik.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 4 në Aneks)

Stafi akademik mbulon në një nivel të kënaqshëm nevojat e programit përsa i takon ngarkesës së orëve dhe harmonizimit të tematikave të ofruara. Sikundër është shpjeguar edhe më lart, kemi një numër prej 6 PAE, të cilët mbulojnë të gjithë ngarkesën e programit ndërsa nuk kemi PAK të cilët marrin pjesë në program (me përjashtim vetëm vitit akademik 2013-2014). Në të gjitha vitet akademike që nga akreditimi i fundit vihet re jo vetëm një nivel i lartë i numrit të pedagogëve por edhe një cilësi e lartë e tyre (gradat e pedagogëve janë kryesisht PhD të kryera jashtë vendit dhe me një specializim në fushën përkatëse të mesimdhënies). Me poshtë po paraqesim një pasqyrë të stafit akademik dhe kualifikimeve të tyre duke nisur nga viti akademik 2013-2014 (në vitin akademik 2012-2013 programi akademik nuk është zhvilluar për mungesë të numrit të mjaftueshëm të studenteve).

- a) Për vitin akademik 2017-2018 gradat e 6 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, dhe 5 PhD/Dr. Ndonese numri i PAE në krahasim me vitin e mëparshëm akademik mbetet i njëjti kemi një rritje të cilësisë pasi numri i PAE me gradën PhD/Dr është rritur gjithashtu nga 5 në 6, çka mendojmë se kontribuon në rritjen e cilësisë së programit.
- b) Për vitin akademik 2016-2017, gradat e 5 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, dhe 4 PhD/Dr. Në krahasim me vitin akademik 2015-2016, kemi një ulje të PAE si në sasi (nga 7 në 6) ashtu edhe në cilësi: numri i Prof. Asoc është ulur nga 1 në 0, numri i PAE me titullin PhD/Dr është ulur nga 5 në 4.
- c) Për vitin akademik 2015-2016 gradat 7 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, 1 Prof. As, dhe 5 PhD/Dr. Në këtë vit akademik nuk kemi një ndryshim të numrit të përgjithshëm të PAE (7) në krahasim me vitin e mëparshëm. Megjithatë kemi një rritje cilësore pasi numri i PAE me gradën PhD/Dr është rritur nga 3 në 5.
- d) Për vitin akademik 2014-2015 gradat 6 PAE të programit janë si vijon: 1 Profesor, 1 Prof. As, 3 PhD/Dr, dhe 1 PAE në procesin e marrjes së grades doktor shkencash. Në këtë vit akademik në krahasim me vitin e mëparshëm kemi jo vetëm një rritje si sasiore të numrit të PAE nga 3 në 6 por edhe një rritje cilësore: 1 Prof. Asoc. dhe 1 PhD/Dr me shumë.



- e) Për vitin akademik 2013-2014 raporti është PAE 3/PAK 2. Gradat e pedagogëve të programit janë si vijon: PAE janë 1 Profesor dhe 2 PhD/Dr. Ndërsa PAK është 1 Profesor dhe 2 PhD/Dr. Nuk mund të bëhet një analizë krahasuese pasi programi në vitin e mëparshëm nuk ka qenë aktiv.
- f) Për vitin akademik 2012-2013 programi nuk ka funksionuar për shkak të numrit të ulët të studenteve të regjistruar.

Të dhënat sipas seksit (Tabela 5 në Aneks)

Në analizën e raportit midis femrave dhe meshkujve (shih Tabelën 5) për vitin akademik 2017-2018 vihet re një lloj njëanshmërie në nivelin e gradave akademike pasi në nivelin e Profesorit dhe Profesorit të Asociuar nuk ka asnjë femër ndërsa në nivelin e Doktorit të Shkencave ky raport është 5/1 në favor të PAE meshkuj. Megjithatë, ky është një trend i cili vihet re pothuajse në të gjitha vitet e akreditimit të programit me përjashtim të vitit akademik 2014-2015 kur raporti PAE meshkuj dhe PAE femra është 4/2 (1 Prof. Asoc dhe 1 PhD Candidate) gjithnjë në favor të PAE meshkuj. Në të gjitha vitet e tjera akademike ky raport është luhatur në raporte shumë favorizuese për PAE meshkuj. Kështu në vitin akademik 2015-2016 dhe 2014-2015 ky raport ka qenë 5/0 në favor të PAE meshkuj. Në vitin 2013-2014, ky raport ka qenë 5/1 (1 ka gradën PhD/Dr). Megjithatë, rritja e numrit të PAE femra në vitet e fundit të programit mund të jetë më e balancuar në të ardhmen duke konsideruar si numrin ashtu edhe nivelin akademik të PAE femra.

Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 6 në Aneks)

Përsa i takon moshën (shih Tabelën 6) vihet re një shpërndarje thuhet e njëtrajtshme e titujve akademike ndërmjet grupmoshave, e cila për PAE është përqendruar kryesisht në moshën 36-45 vjeç për gradën PhD/Dr dhe 56-65 vjeç për gradën Profesor. Ky është një trend, i cili ka karakterizuar të gjithë periudhën e akreditimit. Nderkohe në vitin akademik 2017-2018, 3 PAE i perkasin grup-moshës 36-45 vjeç dhe mbajnë gradën PhD/Dr; ndërsa 2 PAE të tjera me gradën PhD/Dr i perkasin perkatesisht grup-moshave 25-35 vjeç dhe 46-55 vjeç. 1 PAE mban gradën profesor dhe i takon grup-moshës 56-65. Kjo shpërndarje ndërmjet grupmoshave mund të sigurojë një tranzicion fluid ndërmjet brezave të akademikeve të niveleve të ndryshme. Bie në sy fakti se ndërmjet PAE nuk ka asnjë pedagog me gradën Assoc. Prof. cka do të ishte një garanci me shumë për një tranzicion sa më fluid të gjeneratës me të re të PAE dhe përmbushjes së nevojave në rritje të programit për PAE të kualifikuara (me gradën profesor).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Në aneksin e kontratave të paraqitura vihet re se institucioni përgatit nëpërmjet zyres së Burimeve Njerezore kontrata të tipologjive të ndryshme sic janë me kohë të plote apo të pjesshme. Në kontratë parashikohen në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e paleve si edhe ngarkesa e punës dhe objektivat për pedagogët dhe stafin ndihmes. Këto të drejta dhe detyrime janë përgatitur në përputhje me statutin e institucionit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Numri i personelit ndihmes/administrativ është në nivel të kënaqshëm dhe raporti aktual është 7 staf administrativ për 6 pedagoge. Kjo është një premisë për të siguruar mbështetjen e nevojshme si përsa i takon procedurave institucionale ashtu edhe ndihmes për zhvillimin e aktiviteteve mesimore. Staf i administrativ është

ne një raport të mirë edhe me numrin e studenteve (7 staf për 7-8 studente) për të dhënë këtyre të fundit mbështetjen e nevojshme si në nivelin procedural ashtu edhe me bazën mesimore.

Në nivelin administrativ (shih Organigramën e UNYT), çdo fakultet dhe departament kanë administratorët përkatës. Funkcionon gjithashtu edhe Zyra e Karrierës dhe Marrëdhënies me të Diplomuarit, e cila bashkëpunon me një staf-ndihmës pranë çdo departamenti për të koordinuar punën lidhur me nevojat e studentëve. Pranë kësaj Zyre funksionon edhe Keshilli Studentor i Universitetit. Zyra e Marrëdhënies me Nderkombetare është një tjetër strukturë brenda IAL, që fokusohet kryesisht në programet ndërkombëtare dhe së bashku me Zyrën e Projekteve dhe Inovacionit mbështet pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve në këto programe. Zyra e Asistencës Teknologjike mbulon kryesisht infrastrukturën e IAL por edhe ndihmon në mbarëvajtjen e leksioneve (prezantimet, modulet IT brenda programit etj). Pedagogët dhe studentët kanë edhe ndihmën e Zyres së Primitit por edhe Zyren e Sekretarise Mësimore për të lehtësuar dhe mundësuar komunikimin dhe aktivitetin eprditshëm të mesimdhënies.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Ngarkesa e stafit akademik të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Lidhur me angazhimin e personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ në përputhje me objektivat e programeve, ky tregues është i qartë dhe i matshëm angazhimi i personelit ndihmës dhe administrativ, në sajë të informacionit mbi aktivitetet që ato mbulojnë. Përsa i takon personelit akademik zhvillohen procedura përkatëse për matjen e kësaj përpueshmërie siç janë vlerësimi i punës së stafit në lidhje me objektivat e programit të vlerësimeve (<i>Doc. Staff Assessment Policy Document bazuar në Quality Assurance Document, Peer Evaluations of Teaching, si edhe në Individual Performance Assessment</i>). Në këto dokumenta të hartuar nga IAL dhe në dokumente të tjera siç janë strategjia e institucionit parashikohen detyrimet dhe angazhimet e stafit mësimor-shkencor në lidhje me zbatimin e misionit të programit. Specializimi i pedagogëve, numri i tyre i lartë si edhe një numër i konsiderueshëm staf ndihmës, si p.sh. IT, sekretaria mësimore, arkiva dhe administrata krijojnë kushtet për realizimin e strategjisë së IAL e cila synon rritjen vecanerisht rritjen e nivelit mesimor dhe përgatitjen e studenteve me aftësi të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe</p>	<p>Organizimin institucional i departamentit dhe procedura e aprovimit të vendimeve që zbatohet, i mundëson personelit akademik jo vetëm rolin iniciues në propozimin e ndryshimeve në aspektin akademik por edhe në vendimet institucionale që i përkasin programit të studimeve. Në të gjitha hallkat e vendimarrjes stafi</p>

përcaktimi i ngarkesës mesimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

akademik është pjesmarres. Informacioni sqarues lidhur me rolin e personelit akademik në hartimin e kurrikulave përshkruhet në procedurat e hartimit të programit, apo vlerësimit të ndryshimit të programeve kur është e nevojshme. Zhvillimi i kurrikulës dhe vendimet përsa i përket zhvillimit dhe organizimit të programit të studimit bazohen në propozimet e keshillit Shkencor të programit të studimit Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare (*Doc. Teaching Quality Improvement*). Vendimet e propozuara lidhen me zhvillimin e kurrikulës, përcaktimin e lëndëve, caktimin e mbikëqyrësve të tezave etj.

Ka një procedure të qarte rekrutimi, e cila nis nga procedurat e vlerësimit deri tek ato të perzgjedhjes së kandidateve (*Doc. "Policy of Faculty Hiring" and "IR Vacancy Document"*). Kërkesa për personel inicohet nga stafi akademik i departamentit në një periudhë periodike, ndërsa procesi kryhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Ngarkesa mesimore, sic është përshkruar edhe me lart, përcaktohet duke u mbështetur jo vetëm në dispozitat ligjore por edhe në gradën dhe detyrat institucionale të pedagogut. UNYT ka një rregullore mbi ngarkesën mesimore, e cila rregullon ngarkesën e personelit akademik. Perilogaritja e ngarkesës mesimore të personelit akademik bëhet conform kontratës së punës. Në tabelën e paraqitur nga institucioni është përshkruar ngarkesa e punës (për dy vitet e fundit akademike) në ore mesimore për çdo kurs, ku bie në sy një numer relativisht i lartë oresh për çdo pedagog të cilit kanë gradën PhD (edhe për gradën profesor kjo ngarkesë është relativisht e lartë me 130 ore mesimore). Kështu shefi i departamentit ka rreth 185 ore mesimore një ngarkesë e relativisht e lartë duhe pasur parash edhe funksionet e tjera që mund të mbulojë. Ndërsa për pedagogoget e tjere oret mesimore variojnë nga 215-302 ore mesimore. Kjo situatë duket se do të vazhdojë edhe në këtë vit akademik ku shefi i departamentit ka një ngarkesë prej 290 oresh ndërsa pedagogoget e tjere me gradën PhD variojnë nga 240-295 ore mesimore. Kjo ngarkesë mund të ketë impakt në punën kërkimore shkencore të pedagogeve, duke e kufizuar atë, duke pasur parasysh edhe atë që çka na u tha gjatë vizites që pedagogoget mbulojnë edhe funksione administrative në institucion.

Kontrata përgatitet conform legjislacionit shqiptar për punën si dhe conform ligjit nr: 80/2015 të Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë".

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;



Procedura e rekrutimit është në përshtatje me aktet ligjore dhe me rregulloret e institucionit (*Doc. dokumentin "Policy of Faculty Hiring" and "IR Vacancy Document"*). Procedura e rekrutimit nis me publikimin e pozicionit në faqen e internetit të institucionit por edhe në ato ndërkombëtare sic janë Times Higher Education. Me pas në baze të protokollit institucional bëhet renditja e kandidateve në baze të pikave të forta që kanë në lidhje me pozicionin vakant dhe disponueshmërisë së tyre. Me pas bëhet edhe testimi i kandidatëve, të përzgjedhur nga faza e parë nga një komision i posaçëm i cili kryesohet përgjegjësi i departamentit dhe ku bëjnë pjesë edhe



<p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Rektori e Dekani i Fakultetit. Përzgjedhja e kandidateve kalon nepermjet shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur ne zyren e Burimeve Njerezore dhe intervistimit te tyre. Per kandidatet jashte vendit intervista kryhet me ane te Skype. Pas perzgjedhjes nga ana e komisionit, Zyra e Burimeve Njerezore ben verifikimin e dokumentacionit te paraqitur dhe pergatit kontratat.</p> <p>PAE ne kete program perbejne 100% te personelit te angazhuar ne pothuajse te gjitha vitet akademike qe nga viti i pare i akreditimit me perjashtim te vitit akademik 2013-2014 kur PAE perbenin 60% te stafit akademik ndersa PAK 40%. Ne kete vit akademik 2018-2019, per semestrin e e pare rezulton se PAE mbulojne 100 % te ngarkeses se programit te studimit.</p> <p>Procedurat e vleresimit te personelit jane te publikuara online duke siguruar transparencen e ketij procesi dhe mbeshteten mbi dy shtylla kryesore: a) vleresimi i performances se stafit nepermjet pyetesoreve te plotesuar nga studentet; b) vleresimin nga ana e kolegeve te programit ne baze rotacioni. Kjo siguron vleresimin si te cilesise se mesimeshenies ashtu edhe te zhvillimit akademik te stafit. Procedurat kryesore qe ndiqen ne vleresimin e personelit akademik jane perbledhur ne "Staff Assessment Policy Document" si edhe ne raportet vjetore dhe pasqyren e aktivitetet kerkimore dhe botimeve te personelit akademik.</p> <p>Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerezore e institucionit, e cila mban te gjitha bazen e te dhenave te vendeve vakante, nderkohe qe informacioni mbi vendet vakante.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Përgjegjësi i programit ka gradën doktor PhD te marre prane nje institucioni akademik nderkombetar ndersa nga informacionet e paraqitura (CV) del e qarte se ka nje eksperience pune akademike ne universitetet te huaja, si edhe nje numer te larte botimesh ne revista nderkombetare.</p> <p>Pas konsultimit të CV të pedagogëve të programit mund të themi se të gjithë titullarët e lëndëve kanë gradën akademike "Doktor/PDH". Sikunder eshte sqaruar edhe ne pjesen pershkrimore, verehet një lidhje të drejtpërdrejtë midis profilit të tyre akademik dhe lëndës për të cilën janë titullarë. Te gjitha pedagoget e ketij programi i kane perfunduar studimet doktorale jashte vendit.</p> <p>Nga organigrama institucionle dhe informacini i zyles se burimeve njerzore rezulton se Rektori, zv/rektori, dekani, zv/dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin.</p> <p>Ne kete program eshte i detyrueshëm zhvillimi i praktikave mesimore (internship) dhe gjatë vizitës në institucion u informuam se personeli akademik është i mjaftueshëm dhe i specializuar për këtë mbikëqyrje, duke patur parasysh raportin ndërmjet studentëve praktikantë dhe pedagogëve të programit.</p>

praktikave profesionale.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Lidhur me procesin e perzgjedhjes dhe caktimit të tezës, Studenti bën një kërkesë për fushën e studimit përmes një propozimi për tematikë si dhe e dikuton me udhëheqësin e tezës. Gjatë takimit me stafin akademik, gjatë vizitës në UNYT, u informuam se studentëve u ofrohen udhëheqje në kuader të tematikave të zgjedhura, duke patur parasysh interesin e tyre për tematikë të veçanta. Në bazë të tematikave dhe profilizimit të pedagogëve, studentëve u përcaktohet pedagogu, i cili do të ndjekë në hartimin e tezës. Pra zgjedhin tema (për rrjedhojë dhe lëndën brenda të cilës ofrohet ajo dhe pedagogun/en përkatës/e). Ndarja e temave bëhet me miratimin e departamentit apo të më shumë departamenteve në rast se tema është interdisiplinare. Një rol të rëndësishëm në këtë ndarje luan edhe aktivitetet që organizohen në kuader të aktivitetit Graduate Conference, ku studentet shkëmbejnë mendime me njeri-tjetrin dhe me pedagogët lidhur me projektet e tyre kërkimore për zhvillimin e tezave të masterit.</p> <p>Në aneksin IR Student Handbook saktësohet se udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ndjehet me shumë se 10 studente. Zakonisht një udhëheqës ndjek nga 2-5 studente në përgatitjen e tezës.</p> <p>Në dokumentin “Regulation for Exams Tests and Criteria For Graduation e Nivelit të Dytë të Studimeve” përcaktohen kriteret e vlerësimit dhe procedurat që duhet të ndiqen gjatë shkrimit të tezës.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Institucioni cakton udhëheqësit e tezave në baze të përputhjes së tematikave të këtyre të fundit me profilin e akademik të udhëheqësit dhe me fushën e publikimeve. Për të përmirësuar këtë proces, profili akademik i çdo pedagogu është publik në faqen e institucionit. Edhe gjatë vizitës në institucion, gjatë takimit me stafin akademik, mësuam se pasi studenti zgjedh temën i caktohet si udhëheqës pedagogu me profilin përkatës në atë temë.</p> <p>Drejtori i programit vendos lidhur me udhëheqësin e çdo teze duke konsideruar përputhjen midis tematikës së fushës në të cilën do të hartohet teza dhe profilit akademik të udhëheqësit.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personelin ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të</p>	<p>Institucioni angazhon personelin ndihmës si për të ofruar një sërë programesh të cilat synojnë lehtësimin e aksesit të studentëve drejt botimeve online ashtu edhe për përgatitjen e didaktikës mësimore. Raporti i pothuajse 1/1 ndërmjet studentëve dhe stafit ndihmës, na shtyn të mendojmë se angazhimi i personelit ndihmës është në nivelin e kërkuar.</p> <p>Në informacionin e paraqitur në RVB dhe në shotjcen e</p>

<p>dytë.</p>	<p>organigramës lidhur me angazhimin e stafit ndihmes, Akademik dhe Administrativ, si edhe në Statutin e Universitetit shpjegohet organizimi i këtyre strukturave si edhe lista e personave në secilën strukturë. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete ndihmëse (siç është rasti i Zyrës së Marrëdhënies me Nderkombetare apo Zyra e Projekteve dhe Inovacionit) mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave. Kjo është një praktikë që ndiqet në mjaft raste nga UNYT por duhet mbajtur parasysh që ky angazhim të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës. Stafi ndihmës ka një orar të afishuar priti për studentët dhe publikun.</p> <p>Numri i lartë vecanërisht i personelit akademik në krahasim me numrin e studenteve, krijon mundësi për një angazhim më të madh kërkimor dhe shkencor të pedagogëve, ngritja profesionale e të cilëve në planin afatgjatë kontribuon në një përdorim optimal të këtyre burimeve.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Institucioni e ka hartuar ngarkesën mësimore të pedagogëve mbi bazën e dispozitave ligjore dhe merr parasysh gradën dhe ngarkesën institucionale të çdo pedagogu kur përcakton ngarkesën mësimore (<i>Doc. "Staff Assessment Policy Document" bazuar në Quality Assurance Document, Peer Evaluations of Teaching, si edhe në Individual Performance Assessment</i>). Ngarkesa e stafit akademik është e lartë si përsa i takon numrit të lëndëve ashtu edhe përsa i takon orëve mësimore, duke patur parasysh tabelën e dërguar nga institucioni. Kështu PAE me gradën doktor kanë një ngarkesë përgjithësisht një ngarkesë mesatare mbi 250 orë, ndërsa përgjegjësi i departamentit ka një ngarkesë të përgjithshme të lartë me 185 dhe 290 orë mësimore në disa vite akademike (2017-2018 dhe 2018-2019) pavarësisht detyrave administrative e atyre akademike. Pra mund të themi se në përgjithësi vihet re një ngarkesë mbi mesataren si përsa i takon numrit të orëve mësimore ashtu edhe të lëndëve, për periudhën për të cilën është paraqitur dokumentacioni (2017-2018). Kjo u vërtetua edhe nga dokumentacioni i paraqitur gjatë vizitës në institucion.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mbi ngarkesën mësimore, mbi planet mësimore dhe shpërndarjen e pedagogëve sipas lëndëve vërtetohet se ngarkesa e personelit akademik vlerësohet me orë mësimore. Kjo ngarkesë përcaktohet në fillim të vitit akademik kur dhe bëhet shpërndarja e lëndëve. Secilit pedagog i kërkohet një ngarkesë mësimore, mbi normën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, duke konsideruar gradën shkencore dhe funksionet e tjera që kryen pranë institucionit.</p>

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Universiteti disponon një bazë të dhënash të hollësishme për personelin akademik të programit (përfshirë këtu edhe personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit) dhe pjesa më e madhe e këtyre të dhënave është publike në faqen e institucionit. Institucioni disponon një bazë e plotë të dhënash për anëtarët e personelit akademik të programit duke përfshirë si CV e pedagogëve (e cila disponohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore) ashtu edhe publikimet shkencore. Institucioni disponon për çdo semestër listën e plotë të personelit akademik, listë kjo që në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, i dorëzohet edhe Ministrisë së Arsimit (Ref. faqja 25 të RVB). Në bazë të dokumenteve "Policy on Faculty Hiring" (Aneksi 7), institucioni përcakton në mënyrë specifike dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Procedurat e paraqitura si përsa i takon proceseve mësimore ashtu edhe atyre institucionale (sic janë ndjekja e studenteve, pjesëmarrja në vendimarrje apo proceset e rekrutimit) krijojnë mundësi për përmbushjen e kriterëve të paraqitura.
2. Institucioni ka në dispozicion të programit një numër të kënaqshëm pedagogësh dhe stafit ndihmës duke siguruar një ndjekje dhe angazhim pozitiv për studentet.
3. Ka një përputhshmëri të kënaqshme ndërmjet profilit akademik të pedagogëve dhe lëndëve që mbulojnë në program, si edhe tregohet vëmendje në promovimin e publikimeve dhe punës shkencore nga ana e pedagogëve (*Doc. Teaching Quality Improvement*).
4. Vihet re një ngarkesë mbi nivelin mesatar për orët mësimore për pedagogët e angazhuar në program (në të gjitha nivelet akademike) si përsa i takon numrit të orëve mësimore ashtu edhe numrit të lëndëve, çka mund të mos ndikojë pozitivisht në zhvillimin e punës kërkimore nga ana e pedagogëve.
5. Programi mbështetet tek PAE në zbatimin e tij dhe vetëm në një vit akademik kemi një PAK_Raporti PAE/PAK dhe i ngarkesës mësimore ndër vite është si vijon:
2017-2018: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2016-2017: si numër pedagogësh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2015-2016: si numër pedagogësh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2014-2015: si numër pedagogësh është PAE 100% dhe PAK 0%. PAE/PAK si ngarkesë mësimore është PAE 100% dhe PAK 0%.
2013-2014: PAE/PAK si numër pedagogësh është PAE 60% dhe PAK 40%.
2012-2013: Programi nuk është zhvilluar si pasojë e numrit të pamjaftueshëm të studenteve të regjistruar.
6. Ka një shpërndarje të mirë moshore ndërmjet gradave akademike sidomos përsa i takon PAE. Nivelin akademik i PAE shkon pozitivisht përtej përmbushje të detyrimeve ligjore. Kështu nga 6 PAE në vitin akademik 2017-2018, 1 prej tyre ka gradën profesor ndërsa të tjerët kanë gradën PhD/Dr. Me disa variacione të lehta kjo është përgjithësisht tendenca e shpërndarjes së gradave akademike ndërmjet

PAE per pothuajse te gjitha vitet e akreditimit te programit.

7. Programi ka nje Keshill Shkencor te perbere vetem nga pedagoget e programit, cka mund te mos jete gjithmone pozitive pasi kufizon mendimin ndryshe dhe nxit tautologjine ne hartimin e programit mesimor (sidomos ne nje program te tille ku nuk ka PAK ne procesin mesimor).
8. Strukturat ndihmese dhe administrative japin nje ndihme pozitive ne procesin e mesimdhënies dhe atij te kërkimit shkencor.
9. Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të stafit bëhen në përputhje me normat ligjore.
10. Praktika mesimore si nje komponent i detyrueshem i programit ndikon ne jo vetem ne rritjen e intensitetit dhe cilesise se bashkepunimit me partnere, por edhe ndihmon mundesine e punesimit te studenteve (ne vijim te praktikës mesimore) prane ketyre institucioneve ne te ardhmen.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Bazuar në RVB por edhe në vizitën në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton/vlerëson se kushtet infrastrukturore në të cilat zhvillohet mësimi në UNYT janë të përshtatshme për përmbushjen e objektivave të programit në proces kreditimi.

Në tërësi UNYT ofron kushte të përshtatshme infrastrukturore për zhvillimin e procesit kërkimor, procesit administrativ dhe atij shkencor/kërkimor. Kampusi në Kondrën e Diellit është modern dhe në tërësi në parametra të përshtatshëm. Duke qenë që është larg dhe në një hapësirë kodrinore mund të krijojë probleme për studentët me aftësi të kufizuara fizike për të arritur kampusin. Kampusi i UNYT ka mjedise të përcaktuara për klasat e seminareve e leksioneve, për bibliotekën si dhe për aktivitetet e tjera akademike dhe rikreative të cilat janë të rëndësishme për studentët.

Biblioteka e UNYT është e pasur me tekste kryesisht në gjuhën angleze dhe i ofron studentëve mjaftueshëm instrumenta online që të kenë akses në artikujt dhe tekstet më të fundit të fushës së tyre. Edhe laboratorët kompjuterike, si në numër ashtu edhe në cilësi, i përmbushnin nevojat e studentëve sidomos në periudha të ngarkuara të provimeve të mes- apo fund-semestrit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Tabela në Aneks)

• Salla për leksione	11
• Klasa për seminare	2
• Salla për aktivitete promovuese	5
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	-
• Laboratorë për lëndët	4
• Laboratorë informatike	1

- Salla interneti 1
- Salla për bibliotekë 3
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 2
- Zyre informacioni për studentët 7

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 5
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 5
- Zyra për personelin akademik 8

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedisje janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedisje të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka një kampus rezident të përhershëm i cili ndodhet në Kodrën e Diellit si dhe një godinë administrative nga kampusi i vjetër i cili ndodhet tek Komuna e Parisit. Gjatë vizitës në institucion u informuam që shumë shpejt UNYT do të ketë një kampus të ri.</p> <p>Mjediset e institucionit tek Kodra e Diellit janë në dispozicion të institucionit për 15 vjet.</p> <p>Mësim-dhënia zhvillohet në dy godinat kryesore të kampusit të cilat përmbushnin standardet e kerkuara nga ligji si dhe kishin një sistem efikas mexhanimi dhe sigurie në shërbim të mësim-dhënies dhe sigurisë së studentëve në kampus.</p> <p>Ky program studimi praktikat e tij i zhvillon jashtë premisave të institucionit pranë institucioneve të tjera. Gjithësesi, UNYT i ofronte studentëve të programit të gjithë mbështetjen e nevojshme për të ndërmarrë të gjitha aktivitetet që praktika profesionale të jetë e suksesshme dhe frut-dhënëse.</p> <p>Në tërësi, infrastruktura që ofrohej nga Universiteti UNYT ishte i përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe</p>	<p>Nga RVB-ja dhe vizita në institucion u pa se UNYT ofronte një bibliotekë efikase me hapësirë dhe me tekste bashkëkohore. Shumica e teksteve të detyrueshëm për programin e studimit ishin në bibliotekë. Tekstet të cilat nuk ishin fizikisht, mund të aksesoheshin virtualisht nëpërmjet regjistrimeve online që kishte biblioteka.</p> <p>Në bibliotekë kishte edhe shumë tekste të tjera të cilët nuk bënin pjesë në literaturën e detyrueshme të lëndëve.</p> <p>Po aq e rëndësishme në bibliotekë kishte edhe botime periodikësh, sidomos revista shkencore ndërkombëtare, të cilat janë të domosdoshme për studentët e masterit shkencor. Gjithashtu, nëpërmjet regjistrimit në JSTOR dhe Questia, studentët mund t'i aksesonin këto periodikë</p>

<p>për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>online edhe jashtë kampusit duke e lehtësuar akoma më tepër procesin e tyre përgatitor si gjatë semestrit ashtu edhe gjatë sezonit të provimeve.</p> <p>Biblioteka kishte një praktikë ku çdo vit, pas aprovimit të instancave përkatëse, bliheshin tekstet të cilat ishin kërkuar nga pedagogë specifikë apo departamente përkatëse. Edhe pse nuk kishte një limit specifik për departament, biblioteka përpiqej që të mbante një balancë midis departamenteve.</p> <p>Oraret e bibliotekës ishin të përshtatshëm për studentët dhe i ofron atyre mundësi që ta përdornin gjatë periudhës së leksioneve.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Siç tregohet edhe nga analiza e mësipërme, dhe duke patur parasysh edhe numrin e ulët të studentëve në këtë program, institucioni dëshmon se ka një sasi të mjaftueshme klasash për leksione (11), klasash për seminare (2) dhe mjedise të tjera mbështetëse për studentët gjatë procesit akademik.</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore, siç u bë e qartë edhe gjatë vititës në institucion ishin moderne, të mirëmbajtura dhe funksionale në shërbim të procesit mësimor. Gjithashtu stafi teknik mbështetës ishte në dispozicion të zgjidhjes së çdo problemi që mund të lindte gjatë përdorimit të tyre.</p> <p>Salla e internetit dhe laboratori i informatikës përmbanin kompjuter të cilët përmbushnin kërkesat që mund të kishin studentët e programit nën akreditim.</p> <p>Për këtë program studimi nuk ka nevojë për një laborator specifik dhe praktikat profesionale kryhen pranë institucioneve të tjera.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Kampusi i UNYT është i përshtatshëm për kryerjen e një procesi mësimor efikas. 2. Infrastruktura didaktike dhe teknologjike i mundëson pedagogëve të ofrojnë një mësim interaktiv. 3. Biblioteka e universitetit ishte moderne dhe e pasur me libra. Abonimi në depozitorët elektronikë si JSTOR i mundësonte studentëve akses në artikujt më të fundit ndërkombëtare. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

UNYT financohet nga pagesat e studentëve si dhe nga fonde të tjera të fituara nga projektet e donatorëve të huaj apo partnerëve të tjerë ndërkombëtarë. Në përgjithësi, të ardhurat si rezultat i tarifave të shkollës nga studentët përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave të universitetit me të cilat financohet buxheti i përvitshëm i universitetit dhe programit në proces akreditimi.

Përsa i përket kontrollit dhe transparencës financiare institucioni auditohet në mënyrë të rregullt çdo vit nga një kompani e jashtme dhe e çertifikuar e auditit e cila prodhon një raport të detajuar. Gjithashtu, institucioni raporton periodikisht, sipas ligjit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për çeshtje financiare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

Për vitin 2017 ndarjet në përqindje janë si më poshtë:

• Grantet për kërkim	5.4%
• Konsulencat, shërbimet	-
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	94.4%
• Sponsorizimet	-
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	-
• Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	-
• Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	0.2%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Institucioni i ka dhënë të dhënat vetëm në % për zërat shpenzime, paga, dhe investime. Por nuk ka dhënë shifra së sa para konkretisht janë shpenzuar për student në një vit akademik. Gjithashtu nuk janë dhënë të dhëna rrethanore nga të cilat në mund të nxirrim vetë këto konkluzione.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Tabela e përditësuar me të dhënat financiare për programin e studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficientësinë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UNYT dhe kompania mëmë e institucionit kryen sipas kërkesave të ligjeve në fuqi një auditim të brendshëm dhe një të jashtëm ku paraqitet edhe buxheti në dispozicion të programit të studimit. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të të gjithë zërave të ndryshëm të të ardhurave të programit. Nga vizita në institucion u informuam se ky raport përdoret për të analizuar eficientësinë e përdorimit të fondeve të programit dhe kapacitetin që ka programi që të përballojë kostot e veta.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Zyra e financave të UNYT, por edhe vetë kompania mëmë e UNYT ka analiza të qarta të kostove operative të institucionit dhe programit nën akreditim duke filluar nga kostot operacionale, kostot fikse e deri te kostot e kërkimit shkencor.</p> <p>Nga sa pamë në institucion, por edhe bazuar në RVB dhe dokumentat e tjerë të dorëzuar nga UNYT, institucioni dhe porgrami ka qëndrueshmëri financiare dhe ka treguar që është në gjendje të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të mundësuar vazhdimin e programit.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT, bazuar në kërkesat e ligjit dhe rregulloret e tij të brendshme, ndërmer një auditim të përvitshëm të brendshëm e të jashtëm financiar të dhënat e të cilit janë transparente e përdoren për të formuluar planet e zhvillimit të ardhshëm institucional. 2. Bazuar në raportin e auditit institucioni harton një raport financiar të kostove të programit te studimeve dhe në bazë të të dhenave vendos për strategjinë e zhvillimit afat-mesëm të programit. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

UNYT ka në shtruturën e tij Komisionin për Garantimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit (KoGaSCI) i cili ka për detyrë që të ndjekë dhe sigurojë cilësinë e brendshme si dhe të identifikojë problematikat e ndryshme dhe të udhëzojë (bashkëpunojë) me instancat përgjegjëse për adresimin e problematikave të vërejtura. Në përgjethësi, universiteti, dhe sidomos Komiteti, i kushtonin rëndësi sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe merrnin masa që të bëninin kontrole rutinore për cilësinë dhe të adresonin problemet e identifikuara.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
 - o Sa anketime kanë bërë me studentët
 - o Sa studentë janë anketuar
 - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - o Etj

Zyra e kontrollit të brendshëm të cilësisë kryen tre anketime në vit me studentët për të gjitha lëndët mësimore në të tre semestrat e vitit akademik (UNYT ka tre semestra akademikë). Anketimet kryen në fund të semestrit përpara se studenti të marrë notën në lëndë (për të siguruar sa më shumë objektivitet). Të gjithë studentët që janë të pranishëm në klasë marrin pjesë në anketim rezultatet e të cilit më pas përpunohen nga zyra e sigurimit të cilësisë. Rezultatet i përcillen lektorëve të lëndëve, shefave të departamentit dhe dekanit ku identifikohen

problematikat në rang njësie dhe problematikat më individuale nëse ka të tilla. Është përgjegjësia e shefit të departamentit që të marrë masa për rregullimin e problematikave të shfaqura.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Pjese e kontrollit të brendshëm të cilësisë është edhe kontrolli mbi silabuset. Edhe pse pedagogët janë ekspertë të fushës së tyre ato duhet të ndjekin standardet e aprovuara nga universiteti, qoftë në format apo në procedurat e vlerësimit, në mënyrë që të ketë një standardizim pune. Kur zyra identifikon probleme me silabuse të caktuara kontaktohet shefi i departamentit në mënyrë që të zgjidhet çështja. Nga vizita në institucion por edhe nga kontrolli i dokumentacioneve u vu re që mund të bëhej një punë më e mirë në standardizimin e formateve të silabuseve dhe një kontroll më i imtë i përmbajtjes sepse u vune re raste kur kishte probleme. Zyra gjithashtu administron edhe 'peer-to-peer evaluation' ku stafi pedagogjik vlerëson mësimdhënien e kolegëve më junior dhe plotëson formularët përkatës ku pasqyrohen gjetjet dhe sugjerimet përkatëse. Këto dy instrumenta përdoren për tu siguruar që mësim-dhënia të përmbushë kriteret ndërkombetare të cilësisë.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Përvec komitetit, që përbëhet nga 7 anëtarë, për zbatimin në përditshmëri të procesit të punës ka një Koordinator të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë. Koordinatorja administron punën e përditshme të zyrës si dehe administron gjithë dokumentacionin që prodhohet nga monitorimet, sondazhet e studentëve dhe vlerësimet peer-to-peer. As në RVB dhe as gjatë vizitës në institucion nuk u informuam nëse kishte ndonjë person në departament përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga RVB-ja dhe vizita në institucion nuk na u tha nëse stafi akademik ka detyrime për të bërë vetë-deklarim apo vetë-vlerësim të outputit të tyre akademik. Ndoshta kjo praktikë nuk përdoret ngaqë institucioni është ende i vogël dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm të cilësisë janë të mjaftueshëm për mbledhjen e informacionit. Gjithësesi, institucionalizimi i një praktike të tillë do të ishte me benefite për institucioni dhe vetë programin.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Sic është e qartë edhe nga shpjegimet e mësipërme, universiteti ka vënë në jete struktura dhe politika të qarta për të siguruar cilësinë e brendshme ashtu sic e kërkon edhe ligji. Nga vizita konstatuam që gjendja e raportuar rakordonte me atë në terren. Pedagogët bënin vetëvlerësim, zyra e sigurimit të cilësisë kryente sondazhet, dhe në pas të dhënat përpunoheshin deri tek zyra e burimeve njerëzore ku problematikat e identifikuara adresohen në rang individual apo departamental në varësi të problematikës.



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni përdor një sërë mekanizmash për të siguruar cilësinë e brendshme të mësim-dhënies. Specifikisht, UNYT përdor sondazhet e studentëve, monitormimin në auditor si dhe 'peer-to-peer evaluation' ku stafi më me eksperiencë monitoron stafin junior.</p> <p>Informacioni i marrë nga këto burime refkellohet në dosjen personale të stafit akademik si dhe i vihet në dispozicion shefit të departamentit dhe dekanit të cilët kanë të drejtë të marrin masat përkatëse në rastet kur vihen re probleme të përsëritura. Këto informacione përdoren gjithashtu edhe për të strukturuar programin vjetor të trajnimeve që ofrohen për avancimin e stafit akademik të programit në proces akreditim.</p> <p>Rezultatet e vlerësimeve na u vu në dispozicion në RVB dhe u diskutuan edhe gjatë vititës në institucion ku na u bë e qartë se ato ishin një pjesë e rëndësishme e adaptimit të politikave të UNYT për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Sic u tha dhe me lart, institucioni bazohet në mekanizma të tërthorta dhe të drejtpërdrejta për të matur cilësinë si sondazhe të studentëve dhe dëgjime në auditor.</p> <p>Do të ishte mirë po të zbatoheshin edhe metoda e fokus grupit për të patur një panoramë më të plotë të problematikave të mundshme me të cilat përballen studentët.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Disa nga dokumentat që u dorëzuan si pjesë e procesit të akreditimit ishin edhe dokumentat mbi të cilat bazohej dhe strukturohej kontrolli i brendshëm i cilësisë. Në dokumentat e dorëzuara ishte edhe rregullorja dhe manuali i NJSBC-se.</p> <p>Në faqen e internetit të UNYT kishte një seksion të dedikuar kontrollit të brendshëm të cilësisë (http://unyt.edu.al/facilities/quality-assurance/) ku</p>

	ofrohej informacion i bollshëm dhe i bodishëm mbi këtë proces në institucion.
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni, nëpërmejt drejtorëve të programeve harton një analizë vjetore me shkrim për ecurinë e programeve të ciklit të dytë. Një sërë analizash iu ofrua edhe grupit të akreditimit. Këto analiza bazoheshin në rezultatet e kontrollit të brendshëm të cilësisë si dhe në analizën e vete stafit akademik. Raporti më pas i dorëzohej strukturave drejtuese duke sugjeruar edhe ndërhyrje potenciale për adresimin e probleme të ndryshme.</p> <p>Mbi bazën e analizave vjetore janë bërë ndërhyrje në program. Për shembull, bazuar edhe në kërkesat e studentëve gjuha e huaj u zëvendësua me një 'graduate course' i cili ishte më i dobishëm për studentët dhe rriste cilësinë e programit.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>UNYT është i akredituar në nivel institucional dhe programeve të studimit duke përmbushur kështu kërkesat ligjore në fuqi. Institucioni përdor instrumentat e duhura për garantimin e cilësisë. Nga sondazhet e deri tek dëgjimi në klasë, institucioni është i angazhuar për të garantuar cilësinë e mësimdhënies dhe ofrimin e një eksperience akademike sa më të mirë dhe efikase. Siç u tha edhe më lart ndoshta duhet shtuar elementi i fokus grupeve në matjen e kënaqshmërisë së studentëve për të marrë informacione më të plota dhe të thelluara rreth zhvillimeve brenda auditorit.</p> <p>Në planin strategjik të institucionit ka një seksion të dedikuar kontrollit të brendshëm të cilësisë që synon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies e të mësim-nxënies.</p> <p>Gjithashtu, duke qenë se dhe studentët dhe stafi janë të përfshirë në procesin e matjes së brendshme të cilësisë, edhe me sa pamë nga vizita në institucion të dyja palët ishin të informuara mbi këtë proces.</p> <p>Departamenti, programi dhe vetë universiteti kanë strategji zhvillimi (të cilat janë komplemetare) dhe që prekin çeshtje që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm të cilësisë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. UNYT ka një strukturë solide të kontrollit të brendshëm të cilësisë. 2. UNYT nuk ka ende një gamë të plotë të instrumentave për matjen e brendshme të cilësisë dhe korrigjimin e problemeve me formën dhe përmbajtjen e silabuseve. 	
Rekomendime:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Sugjerohet që fokus grupet të përfshihen në instrumentat e përdorur nga universiteti për matjen e brendshme të cilësisë. 2. Për kontrollin e silabuseve, si nga struktura ashtu edhe nga përmbajtja duhen forcuar mekanizmat 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Objektivi kryesor i programit, sidomos në kontekstin e globalizimit dhe demokratizimit mbetet pajisja e studentëve me aftësitë e duhura për të analizuar, kuptuar dhe interpretuar institucionet, aktivitetet dhe interesat e aktoreve kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare. Qëllimi i UNYT është që të përfshijë në programin e MSc në Marrëdhënie Nderkombëtare, studente të cilët vijnë nga një larmi programesh në nivelin Bachelor siç janë antropologjia, ekonomia, shkencat kompjuterike, shkencat politike, marrëdhënie ndërkombëtare, gjuhën angleze apo edhe sociologjinë. Për këtë arsye programi është organizuar në program ndër-disiplinor i cili zhvillohet jo vetëm në kampusin e universitetit por edhe në ambientet e institucioneve diplomatike apo internacionale në Tiranë. Programi synon të ofrojë gjithashtu edhe profesioniste me prejardhje nga politika, diplomacia, administrata publike, të cilët kërkojnë të zhvillojnë me tej njohuritë dhe ekspertizën e tyre në këtë fushë. Për të arritur këtë qëllim, programi është hartuar për të krijuar mundësi të ndjekjes së studimeve jo vetëm nga studentët me kohë të plote por edhe ata me kohë të pjesëshme. Për të lehtësuar pjesëmarrjen e këtyre të fundit, programi parashikon mbajtjen e secilit prej kurseve gjatë fundjavës me kohë të zgjatur (3 ore për çdo lëndë), duke e lënë periudhën gjatë javës në dispozicion të studimit të materialeve të kursit.

Studentët që plotësojnë kriteret e programit marrin një diplomë të UNYT që është ekuivalente me Masterin e Shkencave në sistemin shqiptar të arsimit të lartë. Organizimi i programit është kryer konform rregullave dhe procedurave ligjore në fuqi siç përsa i takon organizimit të programit në vite akademike, semestra, dhe kredite ashtu edhe përsa i takon ngarkesës përkatëse për çdo komponent. Programi ofron edhe një varietet të gjërë formash vlerësimi për studentët duke përfshirur provimet orale me ese, projekte kërkimore apo edhe detyra kurseje siç i përgatit studentët në një nivel më të mirë siç për tregun e punës ashtu edhe për të rritur kapacitetin e tyre kërkimor për të vazhduar studimet në nivelin e doktoraturës, ndërsa i ndihmon studentët "të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikojnë qartë, të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata bëjnë, të njohin rolin dhe rëndësinë e menaxhimit efektiv të arsimit në përmirësimin e shoqërisë dhe anëtarëve të saj".

Programi organizohet në bazë të dy viteve akademike dhe në bazë të sistemit të Bolonjës ofron 120 ECTS (60 ECTS për secilin vit akademik). Vetëm programi është i organizuar në bazë të krediteve ECTS sipas procesit të Bolonjës nga të cilat 80 ECTS përfitohen gjatë lëndëve të përfundimit të lëndëve të parashikuara në planin mësimor dhe 40 ECTS për tezen e diplomës.

Universiteti ofron një bazë të mirë materiale përsa i takon publikimeve dhe aksesit që studentët kanë në dispozicion në libraritë online por nevojitet një punë më e kujdesshme për të rritur aksesin e materialeve të kursit online.



Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i UNYT ne Marredhenie Nderkombetare eshte licensuar me VKM ne vitin 2009 dhe u akreditua nga Ministyria e Arsimit dhe Shkences ne vitin 2012 per nje periudhe 6-vjeçare. Objektivat kryesore te ketij programi studimi kane si qellim pajisjen e studenteve me njohurite e nevojshme per te njohur kuptuar dhe interpretuar menyren se si funksionojne institucionet politike ne pergjithesi dhe ne menyre specifike institucionet nderkombetare. Programi ka nje permbajtje te gjere tematikash dhe ofron mundesine jo vetem per te krijuar nje baze solide njohurish por edhe per te specializuar studentet ne fusha te marredhenieve nderkombetare per te cilat kane interes. Programi ofron nje nderthurje lendesh interdisciplinare duke bashkerenduar jo vetem subjekte nga shkencat politike por edhe nga ajo e ekonomise nderkombetare. Struktura e programit mbeshetet ne disa pika force sic jane: " thelbi, perqendrimi, fokusimi ne fushen e studimit si edhe larmia e lendeve me zgjidhje". Ne mbarim te studimeve studentet duhet te jene ne gjendje te (Ref. RVB):

- "kuptojne teorine dhe praktiken e sistemit politik nderkombetar;
- angazhohen ne procesin e formulimit dhe zbatimit te politikës se jashtme;
- demonstrojne ekspertizen e tyre si rezultat i perfundimit me sukses te nje teze apo profili leksionesh".

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka mesatarisht 28 javë mësimore dhe 480 ore në auditor
- 1 Semestër ka mesatarisht 14 javë mësimore dhe 240 ore në auditor

Ne zbatim te legjislacionit ne fuqi 1 ECTS ka 25 ore mesimore dhe pune te studentit. Nje ore mesimore ka 50 minuta ndersa viti akademik eshte i organizuar ne ECTS dhe ka 60 te tilla. Programi i paraqitur per akreditim ka 120 ECTS, nder te cilat 78 jane caktuar per lendet mesimore, 2 ECTS per zhvillimin e Graduate Conference dhe 40 ECTS jane rezervuar per tezen kerkimore.

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela e Planit ne aneks)

Plani mësimor brenda një cikli të programit është ndarë në dy vite akademike me nga 60 ECTS secili prej tyre, për një total prej 120 ECTS. Ngarkesa e çdo lënde është shprehur në numrin e orëve dhe vlerën respektive në ECTS. Organizimi i moduleve të ofruara është bërë në bazë të raportit orë mësimi ECTS. Orët e mësimi janë të ndara në auditor, seminare dhe punë e pavarur e studentëve (ndërkohë që këtu llogariten edhe orët e shkrimit të tezës së diplomës). Në përgjithësi, në të gjitha vitet e marra në shqyrtim, dhe në të gjitha modulet, ka një shpërndarje orësh e cila favorizon punën e pavarur të studentit (projekteve ne grup apo eseve individuale) në krahasim me orët në auditor, i cili në modulet dhe vitet e paraqitura qëndron në shkallën 1:2,5 ne favor te punes se pavarur te studentit. Mënyra kryesore e vlerësimit të studentëve është provimi, ndonëse në shumicen e moduleve parashihen edhe mënyra të tjera integruese siç janë projektet kërkimore apo puna në grup si pjesë e vlerësimit përfundimtar.

Ne tabelen 11 te paraqitur ne RVB jane nenvizuar lendet me zgjedhje, te cilat jane relativisht te kufizuara dhe ky eshte nje aspekt i programit, per te cilin duhet treguar me shume kujdes. Ofrimi i nje numri me te madh te lendesh me zgjedhje i pergjigjet me mire nevojave qe mund te ken studentet per nje specializim me te suksesshem ne fusha me interes per zhvillimin e praktikave mesimore apo per punesimin e tyre ne te ardhmen.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 40 orë në auditor dhe 140 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret N/A orë në auditor dhe _ N/A orë punë e pavarur e studentit

* UNYT ofron leksione dhe seminare të kombinuara në klasa të integruara në të gjitha nivelet e studimit, përfshirë MSc në IR.

- Teza e Master-it _30_ orë në auditor dhe _1170_ orë të punës së pavarur studentore përgjatë 6 muajve nga përfundimi me sukses i lëndëve të detyrueshme.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela ne Aneks)

Ka vetem zvendesimin e dy lendeve, perkatesisht: 1) Ishte "EU Policy & Governance" ndersa tani eshte: "EU Democracy Promotion" e barazvlefshme me 6 ECTS; 2) Ishte "Gjuhe e huaj Shtese" 8 ECTS, ndersa tani eshte "Nationalism and Ethnic Conflict" 6 ECTS dhe "Graduation Conference" 2 ECTS. Duke qene se ndryshimet ne te dyja lendet ka nje vlere totale prej 14 ECTS atehere ndryshimi nga akreditimi i fundit eshte me i vogel se 20%.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela në Aneks)

Duke u mbështetur në planet mësimore të paraqitura, sic e kemi theksuar edhe me lart, ne te gjithe vitet akademike, per periudhen e akreditimit te marre ne shqyrtim, lendet jane ofruar pothuajse te gjitha nga PAE.

Për vitin 2017-2018: te gjitha lendet (13 lendet) jane ofruar nga PAE.

Për vitin 2016-2017: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2015-2016: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2014-2015: te gjitha lendët janë ofruar nga PAE.

Për vitin 2013-2014: nuk ka nje pasqyre te sakte te kendeve qe jane ofruar nga PAE dhe nga PAK.

Për vitin 2012-2013: programi nuk eshte zbatuar per shkak te numrit te pamjaftueshem te studenteve.

Ne kete table, sic eshte vene ne dukje edhe me lart, bie ne sy fakti se te gjithe lendet jane ofruar nga PAE dhe nuk ka PAK. Sic e kemi theksuar edhe me siper kjo metodologji ka anet e saj pozitive por edhe mund te influencoje ne planin afatgjate ne ngurtesimin e tematikave te programit dhe mungesen e fleksibilitetit apo nevojës per ndryshim.

Ndoshta eshte me vend qe te shpjegohet me mire se cfare nekupton programi i lendes Graduate Conference. Ne rast se ky eshte nj projekt specifik ku studentet pergatisn nje paper (ndoshta mbi tematiken e tezes se tyre) per ta prezantuar perpara studenteve te tjere dhe te marrin verejtje apo sugjerime (nga koleget e tyre apo edhe nga pedagoget qe mund te kryejne rolin e revieëer te paper sic behet ne konferencat ndekombetare) atehere ky aktivitet do te ishte me mjaft interes per studentet. Ne kete menyre studentet jo vetem qe vendosen ne kushtet reale te jetes duke fituar eksperience ne prezantimin e punes se tyre ne nivel akademik (sidomos per ata studente qe duan te vazhdojne me tej me doktoraturen) por nxit edhe mendimin kritik (constructive criticism) tek studente.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Aneksat me syllabuset perkatese per cdo lende (te paraqitura si shtojce e RVB) si edhe materiali i paraqitur nga UNYT, permban pergjithesisht te gjitha informacionet e kerkuara ne pikat e mesiperme. Megjithate prezantimi i syllabus nuk kryhet ne menyre koherente pasi nuk perdoret i njeji template (forma) si edhe jane te ndryshme nga permbajtja. Ne nje syllabus ka nje informacion te pamjaftueshem p.sh. Comparative Politics ndersa ne nje tjetër p.sh. Ethnicity and Nationalism (ndonese ketu mungon emri i pedagogut) shpjegimi eshte shume me i plote dhe i jep studentit informacionin e nevojshem si perpara fillimit te kursit (per ta zgjedhur lenden ose jo) si ne perfundim te tij (per te pare nese i ka realizuar objektivat qe kishte ky kurs). Pavaresisht nga larmia e formave te syllabus te paraqitur, te gjithe ata permbajne informacionet e kerkuara ne pikat e mesiperme.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Tematikat e programi te ofruar kane disa avantazhe sic jane larmia e temave qe mbulojne me ane te nje metodologjie inter-disiplinare (faktor kyç ne nje master sic jane marredheniet nderkombetare) por edhe sasite e tematikave duke krijuar mundesine e nje zgjedhjeje sa me te gjere e cila i vihet ne dispozicion studenteve.

Megjithate mund te ofrohen edhe disa sugjerime:

- Kemi nje numer te kufizuar lendesh te tipi A. Ofrohen vetem 3 lende nga te cilat studentet ne vitin e pare zhvillojne vetem 2 per nje total pre 12 ECTS. Kjo nenkupton qe studentet kane njohuri fillestare mjaft solide dhe te plota. Por ky nuk mund te jete gjithmone rasti pasi ne nje program te tille inter-disiplinar, ku sic theksohet ne RVB (shih faqe 45), studentet mund vijne nga profile te ndryshme sic jane per shembull fakulteti ekonomik apo juridik dhe kane nevojte per me shume lende formuese per te krijuar bazen e nevojshme te cilen e kane studente te cilat kane nje bachelor ne marredhenie nderkombetare apo studime nderkombetare. Per me tej nje numer i ulet lendesh formuese, sidomos ne vitin epare te studimeve, mund te pengoje edhe rritjen e numrit te studenteve qe vijne nga disiplina te ngjashme por nga universitete te tjera, te cilat mund te mos kene patur nje program kaq te gjere gjate ciklit bachelor. Prandaj edhe eshte praktike e aplikuar kurdo qe te kete nje numer te kenaqshem lendesh formuese keshtu qe studentet arrijne te krijojne nje balancim njohurish ne fillim te programit.


Ofrimi i lendeve me zgjedhje ne kete rast do te ishte nje alternative per ata studente qe i kane keto njohuri (ndonese kalimi ne nivelin master kerkon nje sere njohurish te cilat nuk jane te njejta me ato te nivelit bachelor).

- Ne lendet formuese jane ofruar 3 module: Transformation of International Systems; Qualitative dhe Quantitative Methods dhe Culture of Diplomacy (ne semestrin e trete). Duke qene se lenda e dyte ofron njohuri ne fushen metodologjike te kerkimit atehere lenda kryesore qe mbetet per formimin e studenteve me njohurite e nevojshme ne marredhnie nderkombetare eshte Transformation of International Systems. Kjo lende megjithate i trajton teorite e marredhenieve nderkombetare ne aspektin historik dhe perqendrohet ne periudhen e pas-luftes se flohte por nuk ka nje trajtim te teorive the marredhenieve nderkombetare. Teorite e Marredhenieve Nderkombetare ne pergjithese trajtohen si disipline karakterizuese nderkohe qe do te ishte me e arsyeshme qe te ishte e kunderta. Pra qe Transformimi i International Systems te ishte karakterizuese ndersa IR Theory and Practise te ishte nje lende e formimit te pergjithshem.
- Ne tipologjine B jane propozuar 3 module me nga 6 ECTS secili. Nuk ka nje logjike te qarte te ndarjes se lendeve ne grupet B dhe C. Per shembull, per vete prioritetet e vendit por edhe me gjere, politikat integruese te BE-se mund ti perkasin grupit B. Po keshtu duke shqyrtuar syllabus te ketij krusi nuk ka nje shpjegim te qarte se si jane ndertuar dhe funksionojne institucionet evropiane si edhe disa prej politikave evropiane. Integrimi evropian eshte vetem njera prej ketyre politikave ndersa politikave te tjera nuk i eshte kushtuar vemendja e duhur.
- Ne pergjithesi, mendojme se duhet patur me shume kujdes ne akomodimin e moduleve te ofruara ndermjet vitit te pare dhe te dyte te programit, duke i dhene perparesi ne vitin e pare lendeve formuese dhe themelore ne kete fushe, duke i ofruar studenteve mundesine per tu specializuar me tej ne nje ose disa fusha specifike gjate studimit te vitit te dyte.
- Nje tjetër pyetje lind per lendet e grupit E. Ndonese nuk eshte ofruar asnje informacion mbi detyrimet qe duhet te permbushin studentet per te marre 2 ECTS te Graduate Conference, perseri mbetet per tu kuptuar se pse nje nga politicat e EU sic eshte democracy promotion apo i njohur edhe si koncepti i EU democratic conditionality ben pjese ne kete grup. Ne rast se konsiderohet se studentet duhet te kene nje informacion shume me te gjere mbi EU atehere do te ishte me vend qe te organizoheshin aktivitete te cilat kane nje aspekt praktik (ndoshta nje ëorkshop mbi politikat e EU ne bashkepunimin me nje institucion mund te ishte pjese e crediteve qe merrren nga praktika mesimore). Duke marre te mireqene faktin se niveli i gjuhes angleze nuk eshte nje sfide per studentet e ketij programi, aspekte te tjera sic jane lendet informatike apo stazhi dhe praktika mesimore luajne rol ne formimin e studentit prandaj nuk jane shpjeguar plotesisht.
- Më shumë mbetet për tu bërë drejtim të ofrimit të me shume lendeve me zgjedhje per te shtuar larmine e njohurive por edhe mundesine e specializimit te metejsheem te studenteve. Aktualisht ofrohen vetem 3 lende nga te cilat studentet duhet te zgjedhin 2 lende.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Ne përputhje me te dhenat e paraqitura dhe informacionin e prezantuar dhe prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Në bazë të informacionit të prezantuar dhe prezantimit të programeve mësimore për të gjithë periudhën e akreditimit, një student që ndjek programin me kohë të plotë mund të grumbullojë gjatë një viti është zakonisht 60 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i paraqitur ofron nje module te cilet thellojne me tej njohurite e marra ne nivelin bachelor jo vetem persa i takon thellimit te njohurive te marra me pare por edhe ofrimin te moduleve baze apo specializimit ne tematike te caktuara. Organizimi i moduleve me detyra kursi, përgatitje prezantimesh, projekte ne grup, ese individuale gërshetohet me aspektin praktik të programit. Më shumë mbetet për tu bërë drejtim te ofrimin te me shume lendeve me zgjidhje per te shtuar larmine e njohurive por edhe mundesine e specializimit te metejshem te studenteve.</p> <p>Kurrikulumi i paraqitur, trajtimi i tematikave ne syllabus dhe metodologjia interdisiplinare, apo ofrimi i te gjithë programit ne gjuhen angleze, deshmojne synimet e programit per te zgjeruar me tej njohurite e fituara ne ciklin e pare te studimeve.</p> <p>Programi i ofron studenteve pervec lendeve te specializuara edhe soft-skills apo aftesi trasversale sic jane shkrim/lexim akademik, kompetenca ne mendimin kritik apo edhe ne zgjidhjen e problemeve. Vendosja moduleve për metodat e kërkimit shkencor si edhe mjaft aspekte të punës që i kërkohet të bëjnë studentëve brenda kursit por edhe në punën për përgatitjen e tezës së masterit, i pajis studentët me mjetet e nevojshme metodologjike për të vazhduar më tej në karrierën akademike si per shembull studimet doktorale (<i>Doc. Statuti i UNYT dhe Manuali i Sigurimit te Cilesise</i>).</p> <p>Programi ofron njohuri te qendrueshme si ne aspektin e tematikave ashtu edhe ne aspektin teorik te politikave te marredhenieve nderkombetare dhe rrymave kryesore te cilat analizojne sjelljen e institucionave dhe organizatave ne nivel kombetar dhe nderkombetar. Me tej programi pervecse analizon edhe politika publike dhe ato te integrimin ofron edhe nje kurs te vecante per “Qualitative and Quantitative Methodology”. Keto njohuri krijojne nje baze solide per te vazhduar me tej ne ciklin e trete te studimeve.</p>

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve përkrah ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i paraqitur ka një renditje të qarte të objektivave, të përgjithshme dhe specifike, duke ndertuar jo vetëm modulet por edhe strukturat institucionale të nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Kjo ka sjelle një përputhje ndërmjet objektivave dhe nivelit akademik të studimeve që ofrohen. Kriteri përmbushet nga ana e tematikave studimore por në objektivat e programit në të ardhmen duhet të shtohet edhe një ekuilibrim me i mirë i lendeve të formimit të përgjithshëm, formimit karakterizues, atyre integruese, apo lendeve me zgjidhje dhe atyre që ofrojnë njohuri të tjera formuese.</p> <p>Vihet re një larmi formash vlerësimi në program. Përveç provimeve ka edhe vlerësime të ndërmjetme siç janë testet me përgjigje alternative apo prezantimet e projekteve dhe esveve duke harmonizuar në këto mënyra komunikimin oral dhe atë me shkrim (mjafat e rendesishme në ditët e sotme). Fakti se çdo pedagog mund të hartojë vetë format e vlerësimit, siç mesuam në takimin me përgjegjesin e departamentit dhe me komitetin e sigurimit të cilësise, gjatë vizitës në institucion, ndihmon këto larmi dhe e bën vlerësimin jo vetëm me objektiv por edhe me interaktiv për studentin.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disaveçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga vlerësimi i kurrikulumit dhe nga organizimi i silabus (shih syllabus nga 1-15), nga botimet e PAE dhe CV (ku bie në sy eksperiencat në universitet jashtë vendit) e tyre mund të thuhet se programi shfrytëzon eksperiencën e pedagogëve të tij për të ofruar një bazë njohurish të zhvilluar ndër vetë si pranë këtij institucioni ashtu edhe institucioneve të huaja.</p> <p>Nga studimi moduleve të ofruara, silabus, kushteve të pranimit të studentëve (siç është gjuha angleze e detyruar për tu pranuar në program) dhe formave të vlerësimit, larmia e tematikave që mbulohen sidomos nga lëndet me zgjedhje, harmonizimi interdisiplinar i tre disiplinave kryesore (shkenca politike, ekonomike dhe juridike) mund të themi se ky program mund të jetë konkurrues edhe jashtë vendit.</p> <p>Lidhur me faktin nëse programi i studimeve është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, informacioni i paraqitur nuk ofron të dhëna lidhur me këtë aspekt ndonëse informacionet e ofruara në të tjera seksione të vlerësimit dhe dokumentat e bashkëngjitura tregojnë se lidhur me aspektet formale, programi është hartuar në përgjithësi në përputhje me legjislacionin dhe direktivat e BE-së.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programi ofron mundësi që përveç njohurive baze të ofruara në lëndet formuese të kenë edhe aktivitete siç janë ese individuale për pjesëmarrjen në Graduate Conference, ndihmojnë në nxitjen e mendimit kritik dhe stimulojnë e aftësojnë studentet edhe në fushën e kërkimit shkencor. Programi akademik megjithatë duhet të hartohet me mirë në harmonizimin e grupeve të ndryshme të lendeve (siç u përmend edhe më lart) për përgatitjen me të mirë të studentëve jo vetëm në aspektin e kërkimit shkencor por</p>

<p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>edhe per kerkesat e tregut te punes.</p> <p>Programi i marre ne shqyrtim është hartuar në përputhje me ligjet dhe dispozitat në fuqi të Ministrisë së Arsimit. Nje argumentim me i plote i hartimit te tij ne perputhje me strategjine e zhvillimit te IAL eshte shpjeguar ne strategjine e IAL per periudhen 2018-2022, dhe ne strategjine e departamentit per periudhen 2017-2022.</p> <p>Nga nje vzhgim i listes se publikimeve te pedagoqeve te programit dhe moduleve qe ato drejtojne ne kete program, vihet re nje perputhje e kenaqshme. Ndonese ka nje shperndarje jo te njetrajtshme te ketyre publikimeve ndermjet stafit te pedagoqeve (disa prej tyre kane fare pak publikime ndoshta edhe per shkak te mos-azhurnimit te CV te paraqitura).</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Ky standard nuk aplikohet për këtë program</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Ka nje studim ne nivel universiteti, i cili analizon në një mënyrë të përgjithshme kërkesat e tregut të punës por nuk është një studim i dedikuar për këtë program. Vetëm përciptas citohen nevojat e paraqitura ne tregun e punes dhe nuk ka nje informacion te sakte lidhur me nivelin e punesimit te studenteve qe kane mbaruar studimet ne ke program (shih Market Research Strategy). Megjithate fakti qe programi bazohet ne nje program nga Universiteti i New York, mundesia e marrjes se diplomes se dyfishte si edhe zhvillimi i programit ne gjuhen angleze jane qartesisht nje aspekt pozitiv, qe deshmon vleren e ketij programi perballe konkurences. Nderkohe, dokumenti i cituar me siper pasqyron edhe nje analize te konkurrenteve ne tregun e edukimit.</p> <p>IAL zhvillon perpara hapjes së një programi studimi, një studim mbi nevojat e tregut për çdo program të ciklit të dytë që ofron, siç kërkohet nga procesi i akreditimit, kryen. UNYT posedon nje strategji tregu e cila përfshin mundesite e punesimit te studenteve ne sektorin publik dhe privat si brenda ashtu edhe jashte vendit. Ky studim përfshin edhe nje parashkimin te perafert te pritshmerive lidhur me numrin e studenteve si ne UNYT ashtu edhe ne universitete te tjera (Ref. Shtojca 3 dhe 4).</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtarë;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> 	<p>Lidhur me impaktin e e programit te ofruar ne interesat kombetare mund te them qe nga vizita ne institucion (takimi me pergjegjesin e departamentit dhe stafin akademik) si edhe nga diskutimi me studentet nuk u konstatua asnje element ne ate program studimit qe shkonte kunder ineteresave kombetare.</p> <p>Vendosja e impaktit ne komunitet dhe ne zhvillimin e vendit si nje nga objektivat kryesore te universitetit si dhe fushat akademike te studimit me nje interes te dukshem ne analizen e pozites gjeopolitike te vendit dhe njohjese se</p>

9

	metejshme, vecanerisht nga ana e studenteve te huaj, te vlerave kombetare ne pergjithesi dhe atyre kulturore ne vecanti (Ref. shtojca 3 dhe raporti vjetor shtojca 30).
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi i studimeve Master i Marrëdhënies Ndërkombëtare realizohet me 120 ECTS, duke përfshirë mesatarisht 30 ECTS për çdo semestër dhe për tezën, e cila vlerësohet me 40 ECTS, e përgatitur në semestrin e katërt. Kohëzgjatja e studimeve Master i Marrëdhënies Ndërkombëtare është 2 vite akademike.
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Ky kriter nuk aplikohet për këtë program
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;	Informacioni i ofruar është lehtësisht i konsultueshem persa i takon njohurive të përgjithshme dhe identifikimit online e programit të studimit dhe silabus të programit. Ofrimi i dokumentacionit për këto akreditim deshon se programet e studimit dhe syllabuset, të cilat ofrohen për studentet janë të konsultueshme në versionin e tyre elektronik.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;	Plani mesimor i prezantuar në program është i qartë dhe organizimi i ngarkesës mesimore krijon mundësi për diplomimin e studentit brenda afatit të parashikuar. Në programin e paraqitur janë parashikuar 40 kredite për realizimin e tezes.
Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesa më e madhe e kriterëve plotësohen teresisht falë një programi mesimor që ofron një metodologji multi-disiplinare dhe një larmi të gjere tematikash. 2. Procedurat dhe strukturat në dispozicion të programit mundësojnë një nivel të mirë cilësor në mesimdhënie, por në një farë mase, edhe në kërkimin shkencor dhe publikimet e pedagogëve. 3. Organizimi i tematikave duhet të rishihet duke patur parasysh disa sugjerime si përsa i takon orinetimit të mirë ndërmjet moduleve (A, B) por edhe vendosjes në kohë (në viti e parë ose të dyte të programit). Modulet C dhe D duhet të rishihen për të patur një produkt më të mirë cilësor me të mirë cilësor. Në përgjithësi, mendojmë se duhet patur më shumë kujdes në akomodimin e moduleve të ofruara ndërmjet vitit të parë dhe të dytë të programit, duke i dhënë përparësi në vitin e parë lendeve formuese dhe themelore në këto fushë, duke i ofruar studenteve mundësi për tu specializuar më tej në një ose disa 	

fusha specifike gjate studimit te vitit te dyte.

4. Më shumë mbetet për tu bërë drejtim te ofrimit te me shume lendeve me zgjedhje per te shtuar larmine e njohurive por edhe mundesine e specializimit te metejsheem te studenteve. Aktualisht ofrohen vetem 3 lende nga te cilat studentet duhet te zgjedhin 2 lende.
5. Nje studim me i kujdesshem i nevojave te tregut te punes dhe orientimit konform tyre i permbajtjes se moduleve mesimore do te ndihmonte ne specializimin me te mire te studenteve per tregun e pune.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Duke qenë se UNYT ndjek strukturën Amerikane universitare (ofron diploma të dyfishta me Empire State College) strukturimi i mësim-dhënies është i ndryshëm nga struktura klasike e sistemit të Bolonjës. Në UNYT leksioni dhe seminarët nuk janë të ndara. Përveç këtij ndryshimi, një sërë elementësh si kontrolli i njohurive (i ndarë midis midtern, esesë, dhe provimit final), kontrolli i brendshëm i cilësisë dhe aktivizimi i studentëve në mësim-dhënie, është i përshtatur me sistemin e Bolonjës). Specifikisht për programin në akreditim specifika ishte që lëndët organizoheshin të kondensuara në dy muaj të premtë, të shtune dhe të dielë. Kjo është një praktikë e ndryshme të cilën nuk e kemi vënë re në asnjë institucion tjetër që kemi akredituar më parë.

Duke qenë se programi është i vogël numri i studentëve në klasë është ideal për të bërë punë në grup dhe për t'i dhënë vëmendje individuale studentit. Përgjethësisht në leksione dhe seminare përdoren 'case studies' dhe metoda të tjera ku studenti është drejtues aktiv i procesit mësimor dhe mëson duke bërë e duke qenë mendues kritik në klasë. Kontrolli i njohurive bëhet me disa mjete të ndryshme si pjesëmarrja në klasë, detyra të shkurtra të përjavshme që të incentivizojnë studentin të vij i përgatitur në klasë, me ese të gjata, me projekte në grup si dhe me provimin përfundimtar. Normalisht vlerësimi është i shpërndarë gjatë gjithë semestrit për t'i dhënë mundësi studentit që të jetë aktiv gjatë një periudhe sa më të gjatë.

Vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies realizohet ndër të tjera me monitorimin e njoftuar të orëve të mësimit nga vlerësimi 'peer-to-peer'. Në monitorimet e realizuara gjatë orëve të mësimit mbahen shënime të cilat ju referohen drejtuesve të institucionit duke nisur nga Dekani i Fakultetit. Gjithashtu, mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e studentëve merren në konsideratë në kuadrin e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies. Mendimi i studentëve mblidhet nëpërmjet sondazheve që zhvillohen në fund të çdo semestri/lënde.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela e Planit ne aneks):

• Leksione + seminare	520 orë
• Seminare	-
• Ushtrime	-
• Laboratore	-
• Detyre	-
• Praktikë lëndore	-

- Praktikë profesionale -
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Institucioni vë vazhdimisht theksin në kombinimin e praktikave të kontrollit të njohurive të studentëve që njëdekun këtë program. Siç u tha edhe më lart vlerësimi është i shpërndarë në tërësinë e semestrit për të akomoduar sa më shumë stile të të mësuarit, për të incentivizuar studentët të përgatiten jo vetëm në fund si dhe për të 'prodhuar' studentë më etikë të fortë pune dhe aftësi për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Bazuar në RVB-në e programit por edhe nga bisedat që patëm në institucion, vlerësimi ishte i ndarë dhe i shpërndarë në mënyrë të arsyeshme sipas këtij rregulli. Pjesëmarrja në klasë 20% e notës, përbushja e një prezantimi në klasë gjatë semestrit 10% e notës, dorëzimi i esesë (punim kërkimor) 15% e notës dhe provimi përfundimtar 50% e notës. Kjo praktikë i rrit mundësitë e studentëve për të qenë të suksesshëm, rrit dëshirën e tyre për t'u përgatitur në vazhdimësi, dhe i mundëson pedagogut që të vlerësojë në kohë reale se ku po çalon klasa dhe cilat praktika didaktike janë më efektive se të tjerat. Duhet thënë se në silabuse të ndryshme kjo shpërndarje variaonte dhe disa gjithashtu aplikonin edhe praktikën e mid-term. Kjo është arsyeja përse në seksionin e sigurimit të cilësisë së brendshme u sugjerua që të punohej më mirë në këtë sektor për të patur më shumë uniformitet.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Duke qenë se numri i studentëve në program është i vogël, pedagogët kanë njëkohësisht më shumë mundësi të punojnë në mënyrë individuale me to dhe një hapësirë më të vogël rekrutimi. Gjithësesi, nga RVB-ja si dhe nga diskutimi me stafin dhe me studentët u vu re që kishte një vëmendje të kënaqshme ndaj përfshirjes së studentëve në aktivitetin kërkimor të njësisë bazë që ofronte programin nën akreditim. Dy studentë ishin përfshirë në botime shkencore të stafit të programit, 7 janë përfshirë në aktivitete shkencore si simpoziume apo konferenca, dhe 11 në aktivitete shkencore në rang fakulteti. Duke patur parasysh numrin e kufizuar të studentëve në program, ky nivel përfshirjeje është i kënaqshëm.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Studentët pranohen në programin nën akreditim bazuar në kërkesat dhe udhëzimet e ligjit për arsimin e lartë. Nuk ka ndonjë kërkesë tjetër specifike për t'u pranuar në këtë program studimi. Bazuar nga raportimi në RVB studentët në hyrje kanë patur një mesatare mbi 7 dhe një pjesë e madhe e tyre kanë kryer studime apo kanë jetuar për një periudhë jashtë Shqipërisë. Në tërësi studentët e programit vinin nga jashtë UNYT ku pjesa më e madhe kishin studiuar shkencë politike apo marrëdhënie ndërkombëtare në bachelor, por edhe administrim biznesi apo degë të tjera të ngjashme. Në këtë program kishte edhe studentë të huaj si dhe diplomatë të huaj rezidentë në Shqipëri gjë që e rrit më tej nivelin e diskutimit në klasë dhe gamën e mendimit me të cilin përballen studentët gjatë leksioneve dhe seminareve.

Në tërësi, programi kishte një numër të kufizuar studentësh që do të thotë se numri i diplomantëve është relativisht i ulët por cilësia e studentëve si në hyrje (siç u tha edhe më lart) ishte e kënaqëshme. Nga takimet me studentët u vu re se ata ishin të mirë-informuar mbi kohë-zgjatjen e studimeve, praktikat profesionale që mund të bënin, procedurat e diplomimit e kështu me rradhë. Edhe komunikimi me ish-studentët ishte aktiv nëpërmjet zyrës së Alumni e cila mbledhte dhe përpunonte informacion mbi vazhdimësinë e studentëve sidomos përsa i përket punësimit dhe aksesit të tyre në tregun e punës.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Programi bazohet ne kërkesat e ligjit për arsimin e lartë për pranimin e studentëve. Nuk kishte kërkesa shtesë për t'u pranuar në program. Për t'u pranuar në program studenti aplikant dorëzon: diplomën dhe notat e shkollës së mesme, diplomën dhe notat a arsimit bachelor, një CV të përditësuar, 4 fotografi dhe një kopje të letërnjoftimit, si dhe certifikatën e gjuhës së huaj në nivelin B1 / B2.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Në tërësi, cilësia e studentëve në hyrje të programit është e mirë më një mesatare mbi 7 e cila lejon studentët të përthithin nivelin e lartë që kërkon një master shkencor. Ndërsa në dalje niveli është diku më i lartë. Në tërësi, bazuar në RVB dhe në takimin që patëm në institucion edhe me vetë studentët niveli i tyre ishte i kënaqshëm dhe i përshtatshëm për nivelin që kërkohet nga masteri shkencor.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Në vitin e parë të programit 2011-2013 nuk ka patur asnjë student të regjistruar. Në vitin 2012-2014 janë regjistruar 6 studentë për herë të parë më një mesatare në hyrje 7.94.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Në vitin e fundit 2016-2018 janë regjistruar 4 studentë me një mesatare në hyrje 7.4. institucioni nuk ka dhënë të dhëna për notën e tyre mesatare në dalje.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Ka shumë pak mobilitet brenda arsimit të lartë në vend në këtë program studimi pasi UNYT e zhvillon mësimin në anglisht dhe ndjek rregullat e sistemit Amerikan që e bën të aksesueshëm këtë program për një numër të kufizuar studentësh. Gjithësej në këtë program janë tranfesuor dy studentë nga IAL të tjera të vendit.



- Të dhëna për punësimin e studentëve

Sipas të dhënave të ofruara nga UNYT punësimi i studentëve të këtij programi është 100% pasi nga 14 studentë të diplomuar në tërësi 12 prej tyre janë të punësuar jashtë profilit dhe 2 brenda profilit. Kjo ndoshta lehtësohet edhe nga fakti se, sic u informuam edhe gjatë vizitës në institucion, shumica e studentëve të programit ishin të punësuar në momentin e regjistrimit.

- Numri total të diplomuarve

Sic u tha dhe me lart, në bazë të të dhënave të UNYT në RVB, punësimi i të diplomuarve të këtij programi është i plotë, 100%.

- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Edhe pse punësimi është i plotë, punësimi në përputhje me diplomën është në nivele të ulta pasi vetëm 2 nga 14 të diplomuarit punojnë në një fushë që lidhet me formimin e tyre akademik.

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Punësimi kryesor i studentëve të këtij programi ka ardhur jo në përputhje me fushën e tyre të diplomes. 12 nga 14 të diplomuarit janë të punësuar në një sektor jashtë profilit të tyre të arsimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit</p>	<p>Kriteri i parë plotësohet pasi të gjithë studentët e regjistruar në program kishin të paktën një diplomë bachelor me 180 ECTS.</p> <p>Studentët e pranuar në këto program studimi ishin pranuar konform kërkesave ligjore dhe kishin dosje të plotë në institucion që u kontrollua edhe gjatë vizitës në institucion. Studentët gjithashtu plotësonin kushtet e pranimit të institucionit që kishte të njejtat kushte me kërkesat ligjore.</p> <p>Në bazë të kërkesave ligjore, por edhe duke patur parasysh se mësim-dhënia në UNYT zhvillohet në gjuhën angleze, studentët e kishin detyruesë dhënien e provimit të anglishtes si kusht paraprak për pranimin në program.</p> <p>UNYT ishte i ndjeshëm ndaj cilësisë së studentëve por edhe i vetëdijshëm që duhet t'a</p>

<p>European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>ofrojë shërbimin në përshtatje me kushtet e studentëve në Shqipëri. Duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, UNYT nuk kishte shumë hapësira për të bërë ndryshime të mëdha apo të herë pas hershme për këtë ceshtje.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentët e programit të studimeve në akreditim nxiten të zhvillojnë trajnime dhe internshipe në institucione të ndryshme në vend dhe jashtë vendit. UNYT gjithashtu organizon çdo vit Panairin e Karrierës, duke i dhënë studentëve mundësi të orientohen për një karrierë të suksesshme. Gjithësesi duke patur parasyh që pjesa më e madhe e studentëve ishin të punësuar ato nuk kanë shprehur interes të dukshëm për përdorimin e këtyre shërbimeve.</p> <p>Nga takimi që patëm me studentët ata u treguan mjaft të kenaqur me informacionin që kishin për akreditimin e programit dhe vlefshmërinë e diplomës së tyre.</p> <p>UNYT kishte një zyrë për këshillimin e karrierës që organizonte internshipet dhe eksperiencat e tjera profesionale të studentëve. Gjithësesi, me sa pamë nga vizita në institucionin zyra kishte vetëm një të punësuar me disa asistente studente. Ndoshta zyra ka nevojë për më tepër staf që të jetë plotësisht efiçente.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon statistika të vjetore. Këto të dhëna u vunë në dispozicion të grupit të vlerësimit nëpërmjet RVB-së së programit si edhe gjatë vizitës në IAL.</p> <p>Institucioni gjithashtu dispononte statistika vjetore për numrin e studentëve të ciklit të dytë. Këto statistika përditësoheshin në mënyrë kapilare që informacioni të ishte i besueshëm dhe i përdorshëm për të gjitha zyrat që nga sekretaria deri tek alumni.</p> <p>Gjithashtu institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë programit. Këto të dhëna na u vunë në dispozicion nëpërmjet RVB-së si edhe gjatë vizitës në Institucion. Gjithësesi, RVB-ja mund të ishte më e qartë me të dhënat të cilat vende vende ose ishin të paqarta ose ishin të pasakta. Pavarësisht përpjekjeve tona për të marrë informacion të plotë e te saktë ende nuk e dimë se sa është mesatarja e studentëve në dalje.</p>

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;

Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.

Institucioni disponon një dataset të tillë. Nga takimi në institucion u informuam që kjo listë përditësohet periodikisht me të diplomurit e rinj të cilët kontaktohen periodikisht për të marrë informacion mbi statusin e tyre të punësimit dhe ecurinë e karrierës.

Gjatë takimit nuk u diskutua në detaj nëse institucioni mban listë për studentët që vazhdojnë cikle të tjera studimit, por duke qenë se dhe ato kontaktohen, si të diplomuarit e tjerë nga zyra alumni, të dhënat e tyre janë në datasetin e përgjithshëm të statusit të punësimit të studentëve të diplomuar të institucionit.

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

Ky lloj informacioni ofrohet që nga momenti që studentit kontaktonte institucionin me dëshirë apo interes për t'u regjistruar. Këto të dhëna gjithashtu reflektohen edhe në kontratën e firmosur nga student me institucionin. Edhe nga takimi me studentët u vu re se ata ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Me sa u vu re edhe nga RVB edhe nga vizita në institucion dhe takimi me studentët, një nga pikat e forta të programit është qëndrimi afër me studentin duke ndjekur të gjithë ecurinë e tyre. Ndërsa përsa i përket problematikave me karakter mësimor, departamenti, edhe nëpërmjet pedagogëve, i zgjidhte problemet në kohë dhe më cilësi.

Nëpërmjet zyrës së karrierës institucioni i mundësonte studentëve që të bënin internship të ndryshme por jo në formë tradicionale të praktikës mësimore. Internshipet në vetvete ishin positive dhe me ndihme, sic na u tha edhe nga studentët, por në të ardhmen ato duhen adaptuar më mirë me kërkesat ligjore të praktikës profesionale.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni mban të dhëna mbi studentët që ndjekin programin duke përfshirë dosjen e tyre të plotë si dhe progresin e tyre në punësim pas diplomimit.
2. Institucioni i ofron studentëve informacion mbi programin e studimit, kërkesat e tjera ligjore dhe akademike që ato duhet të përmbushin.
3. Institucioni gjithashtu i ofron studentëve mundësi për të bërë internshipe nëpërmjet panairit të punës.

Rekomandim:

Rekomandohet që praktika e internshipeve të institucionalizohet dhe të plotësojë më mirë kërkesat ligjore të praktikave profesionale.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Nga analiza e RVB-së si dhe nga takimi në institucion, u vu re se UNYT dhe programi nën akreditim i kushtonin rëndësi kërkimit shkencor me cilësi dhe që aplikohet në mësim-dhënie. Qoftë nga botimet e stafit akademik, qoftë nga konferencat e organizuara nga departamenti, kërkimi shkencor kishte rëndësi dhe i jepej hapësira e nevojshme.

Në tërësi kërkimi shkencor 'administrohej' nga qendra për kërkim në fakultetin ku strehohej departamenti. Gjithësesi, nuk ishim në gjendje të kuptonim nëse kishte një fond të vecantë për kërkimin shkencor apo nëse kishte një incentiv financiar për ato anëtarë të stafit të cilët botonim punime akademik në revista prestigjioze ndërkombetare.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela ne aneks)

Qendra Kërkimore e Shkencave Sociale koordinaon kërkimin shkencor në nivel Fakulteti si dhe mbledh të dhënat për kërkimin shkencor. Qendra cdo vit publikonte objektivat e saj dhe në fund të cdo viti bente publik arritjet. Këto të dhëna bazoheshin në raportimet individuale të stafit akademik të cilët dorëzojnë planet e tyre kërkimore vjetore si dhe rezultatin e punës së tyre kërkimore në fund të çdo viti. Kjo është një strukturë e qartë që inkurajon dhe kontrollon punën kërkimore të stafit akademik.

Për ta përmirësuar më tej këtë punë, në mënyrë të ngjashme me atë që IAL të tjera në vend kanë bërë, mund të përdoret një sistem pikëzimi për botimet shkencore të lidhura me një bonus financiar për outputet akademike të botuara në revista shkencore me faktor impakti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;	Nga tabelat e RVB-së mbi kërkimin shkencor ishte e qartë se stafi akademik i departamentit që ofron programin ishte tepër aktiv në botimet akademike. Stafi kishte marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe kishte botuar artikuj shkencorë, monografi dhe kapituj në libra të edituar. Këto botime, përderisa janë botuar nga medime me kontroll cilësie nga akademikë të tjerë, kanë potencialin që të avancojnë kuptimin më të plotë të disa nga sfidave me të cilat përballlet Shqipëria në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	

Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;

Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.

Procesi mësimor tek UNYT në të gjitha nivelet e studimit zhvillohet në gjuhën angleze. Stafit akademik që ofron mësim-dhënie ka kryer të paktën një cikël studimesh në gjuhën angleze dhe pjesa dërmuese kishin kryer studimet doktorale në gjuhën angleze në vende anglo-saksone apo në SHBA.

Personeli akademik i përfshirë në mësim-dhënie kishte eksperiencë të gjatë në profesion dhe e kalonte limitin e një semestri.

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

Nga takimi në institucion por edhe nga raportimi në RVB u informuam që UNYT zhvillonte trajnime periodike në rang universiteti për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Edhe qendra kërkimore ofronte, brenda mundësive orientime të ndryshme për avancimin e stafit akademik.

Me sa vumë re nga takimi, nuk kishte një politikë të institucionalizuar për ofrimin e mundësive për kualifikimin e stafit, të paktën jo një mbështetje financiare. Shumica e stafit i gjenin këto mundësi vetë dhe UNYT më pas i krijonte mundësitë, duke i dhënë leje, që ato t'i shfrytëzonin këto mundësi.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Të gjithë anëtarët e stafit kanë detyrim të raportojnë aktivitetin dhe produktin e tyre kërkimor i cili përmbledhet dhe përpunohet në database në nivel universiteti. Bashkë me studimet shkencore institucioni disponon një bazë të plotë të dhënash mbi botimet. Të dhënat specifike për departamentin janë vënë në dispozicion në RVB

Gjithashtu institucioni disponon një bazë të të dhënave për projektet që kanë aplikuar dhe fituar anëtarët e stafit. Specifikisht për anëtarët e stafit të departamentit të dhënat u ofruan në RVB.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni dhe departamenti kanë vëmendje për kërkimin shkencor dhe aplikimin e tij në mësimdhënie.
2. Institucioni mbështet anëtarët e stafit për të ndërmarrë kërkim shkencor nëpërmjet infrastrukturës së kampusit universitar dhe duke i dhënë akses në database të punimeve shkencore si JSTOR.
3. Anëtarët e departamentit janë aktiv në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botimeve të artikujve shkencorë.

Rekomendim:

Rekomendohet që UNYT të institucionalizojë një skemë pikëzimi për botimet shkencore për të ranguar outputin shkencor dhe mundësisht kjo skemë të lidhet me një bonus financiar.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

UNYT ofron diploma te dyfishta ne te gjitha programet e tij akademike me Empire State College, State University of New York. Insitucioni ka zhvilluar nder vite nje vizion i cili eshte prirur drejt bashkepunimit nderkombetar, duke e nisur kete bashkepunim nderkombetar me disa univesitete specifike (State University of Neë-York). Megjithate perseri ky bashkepunim eshte rritur me tej me nenshkrimin e memorandumave dypaleshe te bashkepunimit ne lemin e Shkencave Politike/Marredhenie Nderkombetare si me universitete huaja te tilla si Science Po, Rennes, METU, ashtu edhe me universitetet kombetare si UET, Luarasi, UMB, Polic, Marubi, etj. Pervec fushes se mesimdhenies, ky bashkepunim perfshin edhe shkembimin e stafit akademik per periudha kerkimore ndermjet ketyre univesiteteve. Eshte me rendesi te theksohet se universiteti ka zhvilluar strukturat, sic eshte Zyra e Marredhenieve Nderkombetare apo Zyra e Projekteve dhe Inovacionit, te cilat kane kontribuar jo vetem ne rritjen e aktiviteteve nderkombetare por edhe ne rritjen e nivelit te eksperiences per te permiresuar si nga ana sasiore ashtu edhe cilesore kete bashkepunim ne te ardhmen. Ne vijim po permendim disa nga objektivat e bashkepunimit te UNYT te specifikuar edhe ne Strategjine e Nderkombetarizimit per vitin 2016-2021.

- rritja e marrëveshjeve te bashkëpunimi ndërkombëtar me universitetet lider ne Evrope por edhe me institucione aktiviteti i te cilave eshte me interes per programin ne fjale sic jane ambasadat e huaja apo institucionet nderkombetare te akredituara ne vendin tone.
- promovon përhapjen e informacionit dhe bashkepunimit me IAL te tjera per shfrytezimin e mundesive financiare per kerkime dhe zhvillimin akademik te stafit nepermjet mobilitetit nderkombetar.
- mbeshtetja e Zyres e Projekteve dhe Inovacionit në eksplorimin, vlerësimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore te financuara nga institucionet kombetare dhe nderkombetare.

Institucioni merr pjese ne disa projekte nderkombetare sic jane Erasmus+ cka eshte nje mundesi e mire per te zhvilluar me tej bashkepunimin me universitetet perendimore. Megjithatë, mobiliteti i personelit akademik dhe sidomos studentëve lë akoma vend per permiresim sidomos në projekte ndërkombëtare siç janë Erasmus+ të cilat ndihmojnë për të rritur angazhimin dhe bashkëpunimin me partnerë akademikë ndërkombëtarë. UNYT ka ngritur edhe nje Komitet Perzgjedhes i cili perzgjedh ne baze te kritereve te percaktuara studentet qe perfshihen ne skemat e mobilitetit (si ata qe vijne ne UNYT ashtu edhe ata qe shkojne nga UNYT prane universiteteve te tjera). Për momentin pjesëmarrja në programe ndërkombëtare është relativisht e kenaqshme duke konsideruar moshen e programit. Per me tej informacioni i ofruar ne RVB por edhe informacioni i dhene, gjate vizites ne institucion, paraqet nje strategji të qartë për të spjeguar se si mund të kapërcehen keto vështirësi: keshtu departamenti merr pjese ne disa programe nderkombetare ndersa po pergatitet edhe nje pjesmarrje me e gjere ne programet Erasmus+ dhe Horizon 2020.

Universiteti por edhe programi i marre ne shqyrtim kane lidhje te mira me komunitetin (pjesë kjo edhe e strategjise se zhvillimit 2012-2017) por edhe me partnere nga fusha e biznesit dhe ajo institucionale. Megjithatë lidhjet me tregun e punës nepermjet bashkepunimit me institucionet publike dhe ato te huaja për programin në fjalë duhet te zhvillohen me tej dhe ne kete aspekt institucioni ne pergjithesi dhe programi ne vecanti duhet te ndermarrin hapa konkrete. Kjo do te kontribuojë edhe për të lehtësuar punësimin e studentëve nëpërmjet

kontakteve institucionale të zhvilluara gjate kesaj periudhe me sektorë strategjikë për punësimin e studenteve të kësaj dege.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela ne aneks)

Sic shihet edhe nga tabela 20 (Ref. RVB fq. 85) bashkëpunimi kombëtar dhe nderkombëtar është disa-planësh. Ndonese kemi nje numer IAL me te cilet zhvillohet pjesa kryesore e bashkëpunimit nderkombëtar, perseri kjo ndihmon ne rritjen e eksperiences se stafit, permiresimin e strukturave te insitucionit por edhe ndergjegjesimin e studenteve dhe pedagoqeve mbi nevojen e thellimit dhe rritjes se ketij bashkëpunimi ne te ardhmen. UNYT merr pjese aktualisht si partner ne 21 projekte kombetare apo nderkombetare, ndersa me shume se 31 studente jane pjese e skemave te mobilitetit (si nga ashtu edhe drejt UNYT). Ne me shume se 80 raste, stafi akademik apo studentor i UNYT ka prezantuar punen ne kerkimore ne aktivite akademike te organizuara brenda dhe jashte vendit.

Bashkëpunimi perfshin si marreveshjet kuader me univesitete apo institucione per kryerjen e praktikave mesimore ashtu edhe pjesmarrjen ne projekte nderkombetare dhe programe mobiliteti per studentet dhe pedagoqet.

Nje pune me e mire duhet te behet per balancimin e bashkëpunimit ndermjet te gjithe partnereve akademike dhe jo-akademike sidomos ne vendet e evropes perendimore.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

Ka nje game te gjere bashkëpunimi me institucione qendrore, lokale, kompani dhe aktore te fushes se biznesit dhe mbi te gjitha me universitete brenda dhe jashte vendit. Ne kete menyre eshte siguruar edhe mundesia e zhvillimit te praktikave mesimore, cka eshte nje hap i rendesishem per punesimin e studenteve ne te ardhmen. Ndonese shumica e marreveshjeve jane kuader mirekuptimit dhe jo bashkëpunimi konkret, perseri keto perbejne nje premise te mire nga ku mund te thellohet me tej bashkëpunimi me keto institucione (si akademike ashtu edhe publike).

Megjithate me shume mund te behet per te fokusuar me mire kete bashkëpunimin ne planin akademik duke filluar me projekte kerkimore per ta thelluar me tej ne programe akademike dypaleshe sic eshte rasti i diplomes dypaleshe me Universitetin e New York.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Praktika profesionale eshte një kusht për tu realizuar për studentët që studiojnë në programin Master ne Marrëdhënie Ndërkombëtare. Duke iu referuar informacionit te mesiper, UNYT ka zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi me nje sere institucionesh per kryerjen e praktikave mesimore nga ana e

<p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>studentëve prane këtyre institucioneve. Institucioni ka renditur një sërë institucioneve publike dhe private, kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat mund të lidhe marrëveshje bashkëpunimi ku mund të përfshihen edhe kryerja e praktikave mesimore. Natyrisht që rritja (sidomos e cilesive) së këtij bashkëpunimi me institucioni me të profilizuar në fushën e këtij programi mbetet një sfidë e vazhdueshme edhe për të ardhmen</p>
<p>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p>	<p>Institucioni nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit duke stimuluar pjesëmarrjen e tyre në projekte ndërkombëtare, duke marrë pjesë në projekte si edhe aktivitete akademike ndërkombëtare. Në informacionin e paraqitur si nëpërmjet dokumentacionit por edhe vizitës në institucion spjegohet se si ndahen detyrat brenda personelit të institucionit, ndërmjet stafit akademik por edhe atij ndihmës dhe administrativ. Realizimi i përgjegjësive të marra bëhet nëpërmjet analizave të vazhdueshme për të parë ecurinë e programit ka ndihmuar në këtë drejtim. Një shkëmbim i vazhdueshëm i eksperiencës me qëllim organizimin e punës por edhe ekzistenca e strukturave ndihmëse shihet si një mundësi për të nxitur ndërmjet kolegëve marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>Institucioni inkurajon marrëdhënie bashkëpunimi midis stafit të tij me institucione homologe ndërkombëtare sidomos në SHBA. UNYT konsideron si jetik edhe bashkëpunimin në nivel evropian nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte apo programe që nxisin bashkëpunimin akademik siç janë Erasmus+. Ka një numër të krenarshëm të pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare, si edhe në publikimet jashtë vendit. Të gjitha këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e bashkëpunimit me kolege dhe institucione ndërkombëtare (Universitetit të New York). Ndonese praktika mesimore nuk është e detyrueshme, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucioneve publike dhe private të cilat mund të ndihmojnë studentet si në kryerjen e një stazhi ashtu edhe në vendosjen e kontakteve për një punësim të mundshëm në të ardhmen prane këtyre institucioneve. Institucioni ndihmon dhe mbështet trainimin e mëtejshëm profesional si nëpërmjet fondeve të caktuara për këto qëllime ashtu edhe nëpërmjet aplikimit për projekte brenda buxhetit të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	
<p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p>	
<p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkëpunimi me institucionet publike/private dhe universitetet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është aktiv dhe është institucionalizuar si nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe (si në rastin e Universitetit të New York) por edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte apo konferenca akademike ndërkombëtare. 2. Institucioni bën një punë të mirë për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet pedagogëve si brenda institucionit ashtu edhe me partneret ndërkombëtare. 	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Rekomandimet e lena nga akreditimi i meparshem jane plotesuar.


II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Procesi i vendimmarrjes ne te cilin merr pjese aktive komponenti akademik i programit.
2. Nje numer i larte pedagogesh qe kontribuojne ne modulet e programit, te specializuar jashte vendit dhe me nje cilesi te mire publikimesh.
3. Nje numer i kenaqshem tematikash te ofruara ne programin e studimit qe sigurojne nje mbulim te mire si te njohurive baze por edhe krijojne mundesine e specializimit te studenteve.
4. Vleresimi i punes se pedagogeve si nga ana e studenteve per aspektin e mesimdhenies ashtu edhe nga njeri-tjetri ne bazen e nje sistemi rotacioni.
5. Nje infrastrukture institucionale e mire-organizuar dhe nje mbeshetje financiare per mobilitetin e studenteve dhe pedagogeve nepermjet pjesmarrjes ne projekte nderkombetare sic jane Jean Monet.
6. Nje biblioteke te pasur me tituj dhe materiale online.
7. Pajisja me nje mekanizem antiplagjature sikunder edhe saktesimi i kriterëve per te ndihmuar studentet ne kete drejtim.

b. Pika të dobëta:

1. Numri i studenteve eshte pak i qendrueshem dhe eshte me i ulet ne krahasim me programet e tjera te UNYT, cka mund te ndikojë jo-pozitivisht ne investimin afatgjate per permiresimin e nivelit akademik te programit.
2. Dekania e Fakultetit mban gradë PhD dhe jo titullin "Profesor" siç kërkon neni 42 i Ligjit 80/2015 për Arsimin e Lartë.
3. Nje numer akoma i ulet e pjesmarrjes se studenteve ne projektet kerkimore dhe akademike te pedagogeve dhe grupeve te punes te ngritura prane UNYT (kjo edhe per shkak te cilesise akoma jo shume te larte te studenteve ne program).
4. Mobiliteti i studenteve nga UNYT me universitetet partnere si brenda ashtu edhe jashte vendit eshte akoma ne nivel te ulet.
5. Nje shperndarje jo e mire e tematikave te moduleve ndermjet tipologjive te ndryshme duke i dhene prioritetin e nevojshem moduleve te tipit formues dhe karakterizues. Organizimi i tematikave duhet te rishihet duke patur parasysh disa objektiva si persa i takon orinetimit me te mire ndermjet moduleve (A, B) por edhe vendosjes ne kohe (ne viti e pare ose te dyte te programit).



6. Nje numer i limituar modulesh ne grupin A sidomos gjate vitit te pare.
7. Më shumë mbetet për tu bërë drejtim te ofrimit te me shume lendeve me zgjidhje per te shtuar larmine e njohurive por edhe mundesine e specializimit te metejsheem te studenteve. Aktualisht ofrohen vetem 3 lende nga te cilat studentet duhet te zgjedhin 2 lende.
8. Nje studim me i kujdesshem i nevojave te tregut te punes dhe orientimit konform tyre i permbajtjes se moduleve mesimore do te ndihmonte ne specializimin me te mire te studenteve per tregun e punes.
9. Ngarkese oresh mbi mesataren per te gjithë pedagoget e angazhuar ne program dhe per te gjitha nivelet akademike. Kjo mund te influençoje negativisht ne punen kerkimore te pedagoqeve si pasoje e kohes se pamjaftueshme ne dispozicion.
10. Gjatë analizës se dokumentacionit u vune re disa silabuse problematike ku literatura nuk ishte e perditesuar.

c. Mundësitë:

1. Nje infrastrukture institucionale dhe cilesi mesimdhënie (me mjaft pedagoge me cilesi) qe mund te ndihmoje ne rritjen e numrit te studenteve ne te ardhmen, por edhe te cilesise se metejsheem te pedagoqeve.
2. Kontakte dhe partneritete si ne nivelin akademik ashtu edhe ne ate te institucioneve publike dhe private qe mund te ndihmoje jo vetem ne zhvillimin e metejsheem akademik te programit, por edhe ne organizimin e aktiviteteve extra-curriculare.
3. Eksperience bashkepunimi edhe me universitetet e tjera per te marre pjese me aktive ne kuader te programeve Horizon 2020 cka do te ndihmonte per te rritur nivelin e partneritetit me te tjere univesitete ne Europe dhe SHBA.
4. Mundesia qe krijohet nga shfrytezimi i nje brand i cili mund te krijoje edhe me shume atraksion si per bashkepunimin me universitete te tjera ashtu edhe per permiresimin e rezultateve ne terheqjen e studenteve (si ne sasi ashtu edhe ne cilesi).

d. Pengesat:

1. Shanset me te medha per punesim nga sektori publik dhe nje lloj skepticizmi nga ana e sektorit privat ulin mundesite e punesimit te studenteve te diplomuar prane ketij programi por edhe ul numrin e studenteve te regjistruar ne kete program.
2. Konkurenca e universiteteve te tjera qe kane programe te ngjashme apo edhe e programave te tjera brenda UNYT ka sjelle si rezultat nje numer te ulet studentesh te regjistruar prane ketij programi.
3. Veshitresi ne diversifikimin e burimeve financiare, sic mund te jene projekte apo programe akademike te financuara me bursa studimi, shkakton nje rritje te kosos se studimit qe duhet te paguajne studentet per te siguruar zbatimin e programit.
4. Interesi i studenteve per te patur nje diplome nga nje brand nderkombetar pa u thelluar ne objektivat shkencore dhe akademike te programit limiton rritjen e shpejte te parametrave shkencore.
5. Organizimi i programit gjate weekend me nga tre ore mesimore te premtën, te shtune dhe te dielen mund te sjelle veshitresi ne asimilimin e programit nga ana e studenteve te cilet kane kohe te kufizuar per pergatitjen e materialit mesimore per ditën pasardhese. Po keshtu ky program i ngjeshur gjate

fundjaves, mund te perbeje edhe nje rrezik per nje pa-mjaftushmeri pushimi dhe per rrjedhoje, nje ulje te cilesise se punes nga ana e pedagogeve.

e. Rekomandime:

1. Promovimi me i mire i diplomes te UNYT mund te ishte nje hap i pare ne kete drejtim.
2. Respektimi i kuadrit ligjor ne lidhje me graden akademike te dekanes se fakultetit.
3. UNYT mund te organizoje edhe workshop ku studente mund te paraqesin se bashku me pedagoget ese akademike per te rritur nivelin e studenteve dhe integruar ata ne boten akademike. Me interes ne kete drejtim do te ishte edhe organizimi i aktiviteteve si summer-schools nje-javore me mbledhjen e esseve akademike ne nje tematike te caktuar.
4. Pjesmarrja me aktive vecanerisht ne programet e dedikuara Erasmus + do te ishte nje mbeshtetje ne kete drejtim.
5. Mendojme se duhet patur me shume kujdes ne akomodimin e moduleve te ofruara ndermjet vitit te pare dhe te dyte te programit, duke i dhene perparesi ne vitin e pare lendeve formuese dhe themelore ne kete fushe, duke i ofruar studenteve mundesine per tu specializuar me tej ne nje ose disa fusha specifike gjate studimit te vitit te dyte.
6. Duhet te rritet numri i moduleve te grupit A dhe lendeve themelore pasi kjo ndihmon krijimin e nje baze te shendoshe teorike per studentet.
7. Te rritet numri i lendeve me zgjedhje.
8. Te kryhet nje studim me koherent dhe i detajuar i tregut te punes.
9. Te ulet numri i oreve te mesimdhenies se pedagogeve me qellim jo vetem rritjen e cilesise se mesimdhenies por edhe per te krijuar mundesine per te zhvilluar aktivitete kerkimore-shkencore ne fushat perkatese.
10. NJSBC duhet te forcoje gamen e mekanizmave kontrollues te dokumentacionit dhe silabuseve.

III. SUMMARY ANALYSIS OF THE EXTERNAL EVALUATION ACCORDING TO THE SWOT METHOD.

a. Strengths:

1. The decision-making process, which provides ample room for the academics to participate.
2. A high number of lecturers who have graduated abroad and have good quality publications.
3. A reasonably diverse number of modules offered by the program, which simultaneously cover the basic knowledge and offer opportunities for student specializations.
4. The evaluation of the lecturers' work by both the students as it regards teaching and fellow colleagues based on a rotation system.
5. A well-organized institutional infrastructure and financial support for lecturer and student mobility who participate in international projects such as Jean Monet.
6. A rich library with books and online access to academic materials.
7. Access to a plagiarism detection software and assistance to students regarding how to avoid plagiarism.

b. Weaknesses:

1. The number of students in this program is not stable and it is lower in comparison to other UNYT programs, which might have negative repercussions in the long-term investment for the improvement of this program.
2. The Dean of the Faculty has the academic title of PhD rather than that of Professor as sanctioned in the article 42 of the Law number 80/2015 on High Education.
3. A low number of student participation in the research and academic projects of UNYT lecturers (this because of the yet unsatisfactory student quality in the program).
4. UNYT student mobility with partner universities in and out of the country remains low.
5. A misbalanced distribution of module themes/topics among the different typologies must be addressed by giving the right priority to formative typologies. The typology categorizations must be reorganized by giving the right priority to formative and base typologies. The reorganization must be done with the goal of rebalancing modules in the A and B categories and their placement in time (the first or second year of the program).
6. A limited number of modules in the Group A especially in the first year.
7. More must be done towards offering more elective modules to add to the diversity of knowledge and enable student specialization. Currently, there are only 3 elective modules out of which students choose two.
8. The lack of an in-depth study of the labor market to orient the content of the modules to labor market needs and specialize students accordingly.
9. An above average teaching norm for all lecturers engaged in this program at all levels of study. This might have a negative influence in the research engagement and output of the lecturers due to lack of time.
10. During the analysis of the documentation, it was evidenced that some syllabus were not updated.



c. Opportunities:

1. The existing institutional infrastructure and quality teaching (a high number of young and qualified lecturers) can be instrumental in increasing the number of students for the future and the continuous training of the staff.
2. The network of partnerships at the academic and institutional level with public and private institutions that can aid not only in the future academic development of the program, but also in the organization of joint extracurricular activities.
3. Experience of cooperation with other universities for international research projects such as Horizon 2020 that could help raise the level and type of partnerships with other European and American universities.
4. The opportunity of relying upon the university brand to increase the attractiveness of the program and engender cooperation with other universities, which in turn can raise the level of the current students and increase the level of the upcoming ones.

d. Threats:

1. The fact that most employment opportunities are in the public sector and the private sector remains unconvinced towards graduates of this program, decrease employment opportunities, which in turn depresses student interest in the program.
2. Competition from other universities with similar programs and other programs within UNYT has further depleted the number of students registered at this program.
3. The difficulties in diversifying the financing sources for the program through projects or endowments increases student cost, which is reflected in the high student fees.
4. Student interest in obtaining an international diploma from a Western institution without going in-depth in their studies, limits the raising of the academic and scientific standards.
5. The setup of the modules during the weekend with lectureships on Friday, Saturday and Sunday might produce difficulties in the assimilation of the program from the students who have a very limited time frame to prepare for the following day's readings. Similarly, the condensed weekend structure of the program does not allow lecturers enough rest time and as such could contribute to a decrease of the overall quality of their work.

e. Recommendations:

1. A more effective promotion of this degree might help alleviate this limitation.
2. Fulfil the legal framework concerning the academic title of the Dean of the Faculty.
3. UNYT could organize a workshop where students and lecturers present work done in collaboration to raise student level and introduce them to the academic community. In that regard it might be interesting to organize one-week summer schools where research is conducted regarding a specific thematic.
4. A higher participation in such programs, especially Erasmus +, would be a positive development.
5. We think greater care must be shown in the time frame in which modules are offered by giving priority to formative modules in the first year and allowing in the second year for the students to specialize in a field of their choosing.



6. The number of modules in Group A must be increased as this is crucial for students to create a solid theoretical base.
7. The number of elective modules must be increased.
8. A coherent and detailed study on the opportunities offered by the labour market is advisable to be carried out.
9. The number of teaching hours has to be reduced which we think will not only increase the quality of the teaching activities, but it will also offer the opportunity and time to lecturers to conduct research activities in their area of expertise.
10. NJSBC has to increase the number of mechanisms and tools employed to supervise the available documentation.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Elvin Gjevori PhD

Gert Guri PhD



ANEKSE

Tabela 1: Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK)

Fakulteti i Drejtësisë, Artit dhe Shkencave							
Viti Akademik 2016-2017							
UNYT	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Gjithsej
	Gjit hsej	Tituj/ Grada	Gjit hsej	Tituj/ Grada	Gjit hsej	Tituj/ Grada	
Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale	8	Profesor 1 Prof.Asoc. 5 Dr. 2 Doktorant MSc MA MBA	8	Profesor 1 Prof.Asoc. 4 Dr. 1 Doktorant 2 MSc MA MBA	21	12 MSc 2 MBA 2 MP 5 BA	21
Departamenti i Shkencave Kompjuterike	7	1 Profesor 1 Prof.Asoc. 2 Dr. 1 Doktorant 2 MSc MA MBA	4	Professor 1 Prof.Asoc. 1 Dr. 1 Doktorant 1 MSc MA MBA			
Qendra e Kërkimeve Sociale	7	1 Profesor 1 Prof.Asoc. 5 Dr. Doktorant MSc MA MBA		Profesor Prof.Asoc. Dr. Doktorant MSc MA MBA			
Gjithsej	22		12		21		55

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale							
2017-2018							
UNYT	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Gjithsej
	Gjit hsej	Tituj/ Grada	Gjit hsej	Tituj/ Grada	Gjit hsej	Tituj/ Grada	
Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane	7	Profesor Prof. Asoc. 3 Dr. 1 Doktorant 3 MSc MA MBA	9	2 Profesor 2 Prof. Asoc. 3 Dr. Doktorant 2 MSc MA MBA	21		21
Departamenti i		Profesor		Profesor			

Shkencave Sociale	7	Prof. Asoc. 7 Dr. Doktorant MSc MA MBA	3	Prof. Asoc. 3 Dr. Doktorant MSc MA MBA	12 MSc 2 MBA 2 MP 5 BA	
Qendra Kërkimore për Shkencat Sociale	7	1 Profesor Prof. Asoc. 5 Dr. Doktorant 1 MSc MA MBA		Profesor Prof. Asoc. Dr. Doktorant MSc MA MBA		
Gjithsej	21		12		21	54

Tabela 2. Lista e Stafit Akademik Efektiv (PAE) dhe Stafit Akademik me Kontratë (PAK) në Departamente

Fakulteti i Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave						
Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale						
Viti Akademik 2012-2013						
PAE (Mbiemër Emër)		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/Grada
						Institucioni ku punon me kohë të plotë
1	Ehrlich Adam	Përgjegjës Departamenti	Dr.	1	Vasilika Hysi	Profesor
2	Giakoumis Konstantinos	Anëtar	Dr.	2	Adamis Polycarpos	Dr.
3	Cenko Enila	Anëtar	Dr.	3	Brikena Balli	Dr.
4	Hasanpapa Aida	Anëtar	Doktorant	4	Tom Chionos	Dr.
5	Hasimja Ermal	Anëtar	Dr.	5	Phyllis Cox	Dr.
6	Koka Enkelejda	Anëtar	LLM	6	Dritan Egro	Dr.
7	Olldashi Enkelejda	Anëtar	Dr.	7	Ada Huibregtse	Dr.
8	Ruci Hektor	Anëtar	LLM	8	Illir Kalemaj	Dr.
9	Rukaj Elton	Anëtar	MA	9	Ëilliam Maxëell	Dr.
				10	Harold Neal	Dr.
				11	Aida Orgocka	Dr.
				12	Athanasios Pantazopoulos	Dr.
				13	Idlir Peci	Dr.
				14	Ridvan Peshkopia	Dr.
				15	Gezim Qendro	Dr.
				16	Ioannis Voudouris	Dr.

				17	Sotiris Yanakakis	Dr.	
				18	Eralda Met'hasani	MA	
				19	Valbona Pajo	MA	
				20	Lou Boros	Doktorant	
				21	Ravesa Lleshi	Doktorant	
				22	Adea Pirdeni	Doktorant	
				23	Joana Qelesi	Doktorant	
				24	Nebi Bardhoshi	LLM	
				25	Evisa Kamberi	MA	

Fakulteti i Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave
Departamenti i Shkencave Kompjuterike
Viti Akademik 2012-2013

PAE (Mbiemër Emër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon me kohë të plotë
1	Biba Marenglen	Përgjegjës Departamenti	Dr.	1	Rexhep Meidani	Profesor	
2	Gjini Nertila	Anëtar	Profesor	2	Fatmir Hoxha	Profesor	
3	Holland Trygve-Ben	Anëtar	Profesor	3	Fatos Xhafa	Profesor	
4	Kolaneci Fejzi	Anëtar	Profesor	4	Indrit Troshani	Dr.	
5	Smokthina Emira	Anëtar	Dr.	5	Umut Ulusar	Dr.	
6	Gjebrea Elona	Anëtar	Dr.	6	Erald Vucini	Dr.	
7	Narasimha V. Rao	Anëtar	Doktorant	7	Elior Vila	Dr.	
8	Rojba Gezim	Anëtar	MBA	8	Andi Bejleri	Dr.	
				9	Lulezim Hanceli	Dr.	
				10	Elton Ballhysa	MSc	
				11	Leonard Kasneci	MSc	
				12	Erida Lice	MSc	
				13	Marjana Skenduli	MSc	
				14	Devid Pipa	MSc	
				15	Erita Skendaj	MSc	

Fakulteti i Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave
Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale
Viti Akademik 2013-2014

PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon me kohë të plotë
1	Erlich Adam	Përgjegjës Departamenti	Dr.	1	Hysi Vasilika	Profesor	
2	Holland Trygve-	Anëtar	Profesor	2	Bardhoshi Nebi	Prof. Asoc.	

	Ben						
3	Olldashi Enkelejda	Anëtar	Prof.Asoc	3	Met'hasani Eralda	Prof. Asoc.	
4	Giakoumis Kostandinos	Anëtar	Prof.Asoc	4	Ncal Harold	Dr.	
5	Tarifa Fatos	Anëtar	Dr.	5	Skendaj Elton	Dr.	
6	Cenko Enila	Anëtar	Dr.	6	Ercolani Giovanni	Dr.	
7	Hasimja Ermal	Anëtar	Dr.	7	Gorezi Arnisa	Dr.	
8	Hasanpapa Aida	Anëtar	Doktorant	8	Andianopoulos Andrea	Dr.	
9	Ruci Hektor	Anëtar	LLM	9	Huibregtse Ada	Dr.	
				10	Cili Soljana	Dr.	
				11	Kajsiu Blendi	Dr.	
				12	Kalemaj Ilir	Dr.	
				13	Egro Dritan	Dr.	
				14	Peci Ildir	Dr.	
				15	Petit Hubert	Dr.	
				16	Qendro Gezim	Dr.	
				17	Lleshi Ravesa	Doktorant	
				18	Qeleshi Joana	Doktorant	
				19	Nickeson-Medheim Diane	MA	
				20	Pajo Valbona	MA	
				21	Kambellari Evisa	MA	
				22	Koka Enkelejda	LLM	
				23	Guxholli Aurora	MA	

Fakulteti i Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave
Departamenti i Shkencave Kompjuterike
Viti Akademik 2013-2014

PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada	Institucioni ku punon me kohë të plotë
1 Biba Mareglen	Përgjegjës Departamenti	Prof.Asoc	1 Mejdani Rexhep	Profesor	
2 Gjini Nertila	Anëtar	Profesor	2 Hoxha Fatmir	Profesor	
3 Kolaneci Fejzi	Anëtar	Profesor	3 Gjebrea Elona	Dr.	
4 Nurja Ines	Anëtar	Dr.	4 Mentzeniotis Dionysios	Dr.	
5 Frydas Nikos	Anëtar	Dr.	5 Ulusar Umit	Dr.	
6 Smokthina Emira	Anëtar	Dr.	6 Vila Elior	Dr.	
7 Narasimha V. Rao	Anëtar	Dr.	7 Vucini Erald	Dr.	
8 Rojba Gezim	Anëtar	MBA	8 Ballhysa Elton	Doktorant	
			9 Trendafil Evisa	Doktorant	
			10 Bejleri Erjon	Doktorant	
			11 Kasneci Leonard	MSc	
			12 Lice Erida	MSc	

			13	Pani Gezim	MSc	
			14	Skendaj Erita	MSc	
			15	Skenduli Marjana	MSc	

Fakulteti i Drejtësisë, Arteve dhe Shkencave
Departamenti i Shkencave Humane dhe Shkencave Sociale
Viti Akademik 2014-2015

PAE (Emër Mbiemër)	Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)	Titulli/ Grada	Instituci oni ku punon me kohë të plotë
1 Erlich Adam	Përgjegjës Departamenti	Dr.	1 Hysi Vasilika	Profesor	
2 Holland Ben	Anëtar	Profesor	2 Methasani Eralda	Prof. Asoc.	
3 Canollari Albana	Anëtar	Dr.	3 Gorezi Arnisa	Dr.	
4 Hasimja Ermal	Anëtar	Dr.	4 Peci Idlir	Dr.	
5 Kalemaj Ilir	Anëtar	Dr.	5 Qendro Gezim	Dr.	
6 Anderson Trudy	Anëtar	Dr.	6 Cili Soljana	Dr.	
7 Hasanpapa Aida	Anëtar	Doktorant	7 Demi Neli	Dr.	
8 Ruci Hektor	Anëtar	LLM	8 Egro Dritan	Dr.	
9 Dauti Marsela	Anëtar	PhD	9 Gjebrea Elona	Dr.	
			10 Pajo Valbona	Doktorant	
